

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT
ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMNIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR

2025

Publikuar nga:

Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
Rr. "VIKTOR EFTIMIU"
Ndërtesa 1, Kati IV
Njësia Administrative Nr. 5, 1022
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel. : 00355 4 2258046
<https://www.erru.al>
©Enti Rregullator i Ujit (ERRU)

Shkurt 2026

PËRMBAJTJA

SHKURTIME	1
FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR.....	3
PËRMBLEDHJE	4
1. STATUSI LIGJOR DHE MANDATI I ERRU-SË.....	6
2. VEPRIMTARIA VJETORE E ERRU	7
2.1 OBJEKTIVAT E VITIT 2025	7
2.2 VEPRIMTARIA RREGULLATORE DHE MONITORUESE	8
2.2.1 Licencimi i Operatorëve UK gjatë vitit 2025	8
2.2.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor në Sektor	11
2.2.3 Raporti i Monitorimit të Performancës së Shoqërive UK-Viti 2024.....	19
2.2.4 Bilanci i Ujit	20
2.2.5 Metodologjia e Hartimit të Planit të Biznesit 5 Vjeçar	21
2.3 MBROJTJA E KONSUMATORËVE	22
2.4 TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET E ERRU-SË ME PUBLIKUN DHE MEDIAN	24
2.5 BASHKËPUNIMI DHE MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE.....	24
2.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare	25
2.5.2 Bashkëpunimi me Organizmat Ndërkombëtare	26
2.6 MENAXHIMI ADMINISTRATIV, FINANCIAR DHE ORGANIZATIV	29
2.6.1 Struktura Organizative e ERRU-së.....	29
2.6.2 Të Ardhurat.....	30
2.6.3 Shpenzimet Operative	31
2.6.4 Auditimet	32
2.6.5 Statusi i Ankimeve Gjyqësore	33
3. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SEKTORIT UK	34
3.1 PRONËSIA.....	34
3.2 GJENDJA E SEKTORIT UK	34
3.2.1 Shfrytëzimi dhe kontrolli i ujësjellësve	34
3.2.2 Kapaciteti i trajtimit dhe shpërndarjes së ujit si dhe parashikimi i kërkesës për ujë në të ardhmen.....	35
3.2.3 Licencat dhe Tarifat	36
3.2.4 Investimet në Sektorin UK	38
3.2.5 Subvencionet për vitin 2025	40
3.2.6 Treguesit Kryesor të Performancës 2025	41

4.	ZBATIMI I REKOMANDIMEVE	43
4.1	Progresraporti i BE-së për Shqipërinë.....	43
4.2	Rezoluta e Kuvendit	43
4.3	Niveli i zbatueshmërisë nga Ekzekutivi i Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura.....	50
5.	OBJEKTIVAT E ERRU-SË PËR VITIN 2026	53
6.	REKOMANDIME TË ERRU-SË PËR SEKTORIN UK.....	54
Aneksi nr. 1	Licencimet	58
Aneksi nr. 2	Tarifat për Shërbimin e FU dhe Largimit të UN Viti 2025	59
Aneksi nr. 3	Performanca viti 2024.....	60
Aneksi nr. 4	Bilanci i Ujit 2024.....	61
Aneksi nr. 5	Mbledhjet dhe Vendimet e KKRR, Viti 2025.....	62
Aneksi nr. 6	Referencat Ligjore	64

SHKURTIME

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
AK	Autoriteti i Konkurrencës
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
BE	Bashkimi Evropian
DMA	Zona të Matjes me Sistem Inteligjent
DSIP	Planet e Zbatimit të Direktivës Specifike
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
FU	Furnizimi me Ujë
GNPIE	Grupi Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian
IAWD	Shoqata Ndërkombëtare e Shoqërive të Shërbimeve të Ujit në Rajonin e Danubit
IPIS	Sistemi i Integruar i të Dhënave dhe Treguesve Kryesorë të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimin të Ujërave të Pijshëm
ITUN	Impiant i Trajtimin të Ujërave të Ndotura
IWA	Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
KE	Komisioni Evropian
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KM	Këshilli i Ministrave
KUN	Kanalizimi i Ujërave të Ndotura
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
O&M	Kosto Operative dhe Mirëmbajtjeje
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
RAAEY	Autoriteti Rregullator Grek për Energjinë, Mbetjet dhe Ujin
SECO	Sekretariati Shtetëror Zvicëran për Çështje Ekonomike
SHA	Shoqëri Aksionere
SHRUK	Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime
SHUKALB	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë
SHUKOS	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Kosovës
SKP	Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta
TKP	Treguesit Kryesorë të Performancës
TAIEX	Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit
U	Ujësjetllës
UK	Ujësjetllës Kanalizime
UN	Ujërat e Ndotura
UPA	Uji Pa të Ardhura
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WAREG	Shoqata e Rregullatorëve të Ujit të Evropës
ZAM	Zgjidhje Alternative e Mosmarrëveshjeve

FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR

Të nderuar,

Viti 2025 përfaqëson një fazë të rëndësishme konsolidimi për sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (në vijim sektori) në Shqipëri. Pas një periudhe intensive riorganizimi dhe rajonalizimi, fokusi është zhvendosur drejt forcimit të qëndrueshmërisë financiare, përmirësimit të performancës dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Në këtë kontekst, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (në vijim ERRU) ka ushtruar me përgjegjësi të plotë mandatin e tij ligjor, duke garantuar zbatimin e kuadrit rregullator, transparencën në vendimmarrje dhe balancimin e interesit publik me nevojën për qëndrueshmëri ekonomike të operatorëve. Veprimtaria jonë gjatë këtij viti ka qenë e orientuar drejt krijimit të një sektori më të strukturuar, më efikas dhe më të harmonizuar me standardet evropiane.

Raporti Vjetor 2025 përfaqëson një instrument thelbësor llogaridhënieje ndaj Kuvendit të Shqipërisë dhe publikut. Ai pasqyron vendimmarrjet kryesore në fushën e licencimit dhe rregullimit tarifor, monitorimin sistematik të performancës së shoqërive rajonale, si dhe progresin e arritur në zbatimin e reformës sektoriale.

Gjatë këtij viti janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për konsolidimin institucional të shoqërive rajonale dhe për forcimin e mekanizmave rregullatorë që garantojnë qëndrueshmëri, përgjegjshmëri dhe transparencë. Paralelisht, mbrojtja e interesave të konsumatorëve ka mbetur një prioritet i pandryshuar, përmes vlerësimit të përballueshmërisë së tarifave, trajtimit të ankesave dhe sigurimit të proceseve të hapura e të konsultuara.

Procesi i reformës ka hyrë tashmë në një etapë ku theksi vendoset jo vetëm në strukturimin institucional, por mbi të gjitha në përmirësimin real të performancës dhe rritjen graduale të cilësisë së shërbimit. Në këtë drejtim, ERRU do të vijojë të ushtrojë rolin e tij si autoritet i pavarur, duke mbështetur zhvillimin e një sektori të qëndrueshëm, efikas dhe në shërbim të qytetarëve.

Me përgjegjësi të plotë ndaj Kuvendit dhe publikut, mbetemi të angazhuar për të garantuar që sektori të vijojë rrugën e konsolidimit dhe modernizimit, në përputhje me objektivat kombëtare dhe procesin e integritetit evropian.

Gerta Lubonja

Kryetar

PËRMBLEDHJE

Ky raport vjetor paraqet veprimtarinë e ERRU-së gjatë vitit 2025, si dhe zhvillimet kryesore në sektor në Shqipëri, në përmbushje të detyrimit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, i ndryshuar, sipas të cilit ERRU raporton çdo vit në Kuvendin e Shqipërisë.

Raporti vjetor 2025 ofron një pasqyrë të aktiviteteve rregullatore të zakonshme dhe të veçanta, si edhe të zhvillimeve kryesore në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve. Ai përfshin analizë dhe vlerësim të bazuar në praktikën e raportimit të përcaktuara në ligjin e sipërcituar dhe në Manualin e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit Parlamentar, të miratuar nga Kuvendi.

Gjatë kësaj periudhe, veprimtaria e ERRU-së është zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, si dhe në referencë të objektivave të Strategjisë Kombëtare të Sektorit 2023–2030 dhe Strategjisë Institucionale të ERRU-së. Gjithashtu, vlen të theksohet se reforma e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve ka vijuar të avancojë gjatë vitit 2025, duke thelluar gradualisht procesin e rajonalizimit dhe duke orientuar sektorin drejt një modeli më të qëndrueshëm financiar dhe institucional. Edhe pse riorganizimi nuk është përmbyllur plotësisht, zhvillimet e kësaj periudhe dëshmojnë për një qasje më të strukturuar në drejtim të planifikimit, menaxhimit dhe forcimit të qeverisjes sektoriale.

Në këtë kuadër, procesi i licencimit ka garantuar vazhdimësinë ligjore të funksionimit të sektorit dhe respektimin e standardeve të përcaktuara për drejtimin teknik dhe ligjor të shoqërive. Gjashtë shoqëri ujësjellës-kanalizime kanë aplikuar për rinovim licence ose për ndryshime të drejtuesve ligjorë dhe teknikë, nga të cilët aplikimet e pesë shoqërive rajonale UK janë miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator (në vijim KKRR) për vitin 2025. Si rezultat, 17 operatorë kanë ushtruar veprimtarinë e tyre të pajisur me licencë të vlefshme. Rënia progresive e aplikimeve krahasuar me vitet e mëparshme reflekton përfundimin e fazës intensive të riorganizimit sektorial dhe hyrjen e reformës në një fazë më të qëndrueshme zhvillimi.

Procesi tarifor ka përfaqësuar një nga instrumentet kryesore të forcimit të qëndrueshmërisë financiare të sektorit. Analiza tekniko-ekonomike e aplikimeve ka çuar në miratimin e tarifave të reja për tre shoqëri rajonale: Korçë, Elbasan dhe Berat. Për herë të parë është aplikuar metoda “Çmimi Tavan” SHRUK Korçë, ndërsa për dy shoqëritë e tjera është zbatuar metoda “Kosto Plus”.

Tarifat e miratuara parashikojnë përmirësim të ndjeshëm të mbulimit të kostove operative:

- SHRUK Korçë, mbi 120% gjatë periudhës rregullatore 2025–2029;
- SHRUK Berat, rritje progresive nga 108.6% në 118.6% gjatë periudhës 2025-2027;
- SHRUK Elbasan, përmirësim gradual nga 78% në 83.6% gjatë periudhës 2025-2027.

Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve të performancës, përmirësimi i kanaleve të informimit si dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve, vlerësimi i përbalueshmërisë së tarifave të shërbimit nga përfituesit, garantimi i zhvillimit të seancave dëgjimore nga shoqëritë në proceset e rishikimit të tarifave, janë ndër instrumentet kryesore që ERRU ka përdorur për të mbrojtur interesat e konsumatorëve.

Një zhvillim me rëndësi strategjike gjatë vitit 2025 është miratimi dhe zbatimi i Modelit të Planit të

Biznesit 5-vjeçar për shoqëritë rajonale. Ky instrument krijon lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet strukturës tarifore, objektivave të performancës, programeve të investimeve dhe menaxhimit të aseteve. Përmes këtij modeli, tarifat analizohen në kuadër të një plani të integruar zhvillimi afatmesëm, duke forcuar përgjegjshmërinë e operatorëve dhe transparencën në përdorimin e burimeve financiare.

Në përmbushje të funksionit monitorues, në korrik 2025 është hartuar dhe publikuar Raporti i Monitorimit të Performancës për vitin 2024. Ky raport, i bazuar në të dhënat ekonomiko-financiare dhe tekniko-operative të vitit 2024, paraqet një analizë të detajuar të gjendjes së sektorit. Rezultatet tregojnë progres të matshëm financiar dhe operacional: mbulimi i kostove operative (O&M) në nivel sektori ka arritur në 107.6%, ndërsa mbulimi i kostove totale në 83.2%. Shërbimi i furnizimit me ujë mbulon rreth 77.8% të popullsisë në juridiksion dhe prodhimi vjetor i ujit ka arritur në 302.8 milion m³.

Në vijim të këtij procesi analitik, gjatë vitit 2025 është përgatitur edhe Bilanci i Ujit për vitin 2024, si një instrument kyç i monitorimit rregullator. I hartuar sipas metodologjisë së Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA), Bilanci i Ujit 2024 ka siguruar unifikim të treguesve dhe krahasueshmëri ndërmjet shoqërive. Nga analiza rezulton se 64.8% e ujit të prodhuar është raportuar si i matur dhe 35.2% si i vlerësuar. Konsumi i autorizuar i faturuar përbën rreth 39% të ujit të prodhuar.

Treguesi i Ujit Pa të Ardhura (UPA) rezulton rreth 61% në nivel kombëtar. Megjithatë ky tregues mbetet një nga sfidat strukturore të sektorit, krahasuar me vitet paraardhëse vihet re përmirësim gradual si rezultat i reformës dhe përmirësimit të praktikave menaxheriale. Rezultatet e Bilancit të Ujit shërbejnë si bazë për orientimin e vendimmarrjes tarifore dhe përcaktimin e objektivave për reduktimin e humbjeve.

Veprimtaria institucionale e ERRU-së gjatë vitit 2025 është ushtruar në përputhje me buxhetin e miratuar, duke garantuar administrim të kujdesshëm të fondeve publike dhe transparencë në përdorimin e tyre. Proceset e auditimit dhe inspektimit kanë kontribuar në forcimin e llogaridhënies dhe integritetit institucional.

Bashkëveprimi me institucionet dhe aktorët publikë ka qenë i domosdoshëm për ERRU-në në ushtrimin e funksioneve të tij. Ky ndërveprim nuk kufizohet vetëm në raportimin ndaj Kuvendit apo ndjekjen e rekomandimeve të tij, por shtrihet edhe në koordinimin me institucionet ekzekutive të sektorit dhe në krijimin e lidhjeve me organizma të ndryshme që kontribuojnë në këtë fushë. Kështu është ndërtuar një rrjet partneriteti që ndihmon në zhvillimin dhe përmirësimin e sektorit.

Në planin ndërkombëtar, gjatë vitit 2025, ERRU ka vijuar angazhimin aktiv si anëtare e WAREG duke sjellë perspektivën kombëtare mbi politikat tarifore, qëndrueshmërinë e sektorit dhe harmonizimin me direktivat e BE-së. Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Autoritetin Rregullator Grek dhe vijimi i bashkëpunimit me rregullatorin homolog në Kosovë kanë konsoliduar dimensionin rajonal dhe evropian të institucionit.

Gjithashtu, në kuadër të programit TAIEX janë bashkë organizuar seminare mbi raportimin e të dhënave dhe reduktimin e humbjeve të ujit. Mbështetja e donatorëve si Banka Botërore, Qeveria Austriake, BE, UN-Habitat dhe programet e Partneritetit të Danubit ka mundësuar asistencë teknike, trajnime dhe përfshirje në dialogun global mbi investimet dhe menaxhimin e sektorit.

Në tërësi, viti 2025 përfaqëson një etapë të rëndësishme të avancimit të reformës në sektor, me progres të dukshëm në aspektin financiar, rregullator dhe institucional. Zhvillimet e këtij viti krijojnë një bazë më të qëndrueshme për vijimin e reformave dhe për përmirësimin gradual të performancës së sektorit, në funksion të garantimit të një shërbimi më cilësor dhe të qëndrueshëm për qytetarët.

1. STATUSI LIGJOR DHE MANDATI I ERRU-SË

ERRU është institucion publik i pavarur, i krijuar dhe që vepron në përputhje me Ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar. Prej më shumë se 28 vitesh, ERRU ushtron kompetencat e tij si autoritet rregullator dhe mbikëqyrës i sektorit, duke garantuar zbatimin e kuadrit ligjor dhe mbarëvajtjen e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Republikën e Shqipërisë. Në këtë cilësi, ai luan një rol balancues, duke siguruar që shoqëritë UK të licencuara të përmbushin detyrimet e tyre ligjore, ndërkohë që mbron interesat e konsumatorëve.

Misioni i ERRU-së është të rregullojë dhe mbikëqyrë sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, në mënyrë që të garantohet ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme, cilësore dhe të përballueshme për qytetarët, duke promovuar përgjegjshmëri, eficiencë dhe transparencë në veprimtarinë e operatorëve.

Vizioni i ERRU-së është ndërtimi i një sektori uji financiarisht të qëndrueshëm, teknikisht efikas dhe të harmonizuar me standardet evropiane, në të cilin balancohet interesi publik me zhvillimin e qëndrueshëm të operatorëve.

Në kuadër të mandatit të tij, institucioni ushtron përgjegjësi thelbësore që nisin me procesin e licencimit të subjekteve që operojnë në sektor, duke përcaktuar kushte të qarta dhe standarde të detyrueshme për ushtrimin e aktivitetit. Përmes këtij procesi sigurohet që çdo operator të përmbushë kriteret teknike, financiare dhe ligjore të përcaktuara në legjislacion.

Rregullimi tarifor përbën një tjetër shtyllë qendrore të veprimtarisë së ERRU-së. Përcaktimi dhe miratimi i tarifave të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve realizohet mbi bazën e metodologjisë të unifikuar, me qëllim ruajtjen e një ekuilibri të qëndrueshëm ndërmjet përballueshmërisë për konsumatorët dhe qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK.

Mandati i institucionit shtrihet gjithashtu në monitorimin e vazhdueshëm të performancës së shoqërive ujësjellës-kanalizime, përmes analizës së treguesve teknikë, financiarë dhe operacionalë, si dhe në formulimin e rekomandimeve për përmirësimin e eficiencës dhe cilësisë së shërbimit.

Në rastet e konstatimit të mos respektimit të kuadrit ligjor rregullator apo kushteve të licencës, ERRU ka autoritetin për të ndërmarrë masa administrative, duke siguruar kështu llogaridhënie të plotë në të gjithë sektorin.

Përgjatë vitit 2025, në zbatim të “Strategjisë Kombëtare të Sektorit për Furnizimin me Ujë të Pijshëm, Largimin, Grumbullimin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane 2023–2030”, miratuar me VKM nr. 448, datë 26.07.2023 dhe “Strategjisë Institucionale të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, miratuar me vendim të KKRR nr. 30, datë

23.09.2024, ERRU është fokusuar në përmbushjen e objektivave sektoriale për garantimin e një shërbimi të qëndrueshëm dhe cilësor në furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe në rritjen e efikasitetit të sektorit.

2. VEPRIMTARIA VJETORE E ERRU

Në vijim të mandatit ligjor dhe objektivave strategjikë të institucionit, kjo pjesë e raportit paraqet në mënyrë të detajuar veprimtarinë e ushtruar nga ERRU gjatë vitit 2025. Analiza që pason pasqyron masat e ndërmarra, vendimmarrjen rregullatore, aktivitetet monitoruese dhe ndërveprimin institucional, në funksion të përmbushjes së përgjegjësisë të përcaktuara me ligj dhe garantimit të një sektori më të qëndrueshëm, transparent dhe eficient.

2.1 OBJEKTIVAT E VITIT 2025

Për vitin 2025, ERRU ka përcaktuar një sërë objektivash prioritare, të cilat adresojnë zhvillimet kryesore të sektorit dhe nevojën për forcimin e instrumenteve rregullatore dhe institucionale. Këto objektiva përbëjnë bazën e veprimtarisë së institucionit përgjatë vitit raportues dhe synojnë të konsolidojnë progresin e arritur në kuadër të reformës sektoriale.

- **Përfundimi i procesit të miratimit të tarifave për të gjitha shoqëritë rajonale UK**, të krijuara në kuadër të riorganizimit të sektorit, si dhe ofrimi i asistencës rregullatore për zbatimin efektiv të metodologjisë tarifore.
- **Miratimi i Modelit të Planit të Biznesit për shoqëritë UK dhe udhëzuesit përkatës**, i detyrueshëm për zbatim në procesin e aplikimit për nivele të reja tarifore, në vijim të marrëveshjes së nënshkruar me AKUK.
- **Krijimi dhe funksionalizimi i një sistemi të unifikuar kombëtar për raportimin e të dhënave në kohë reale**, me qëllim rritjen e saktësisë, besueshmërisë dhe transparencës së informacionit sektorial.
- **Forcimi i rolit ndërinstitucional të ERRU-së**, përmes bashkëpunimit me të gjithë aktorët e sektorit në realizimin e objektivave strategjikë sektorialë dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm për shoqëritë UK.
- **Kontributi aktiv në procesin e integritetit evropian**, në kuadër të negociatave për anëtarësim në BE, duke adresuar kërkesat e *acquis communautaire* në lidhje me Direktivat Evropiane për Ujin e Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe Llumrat e ITUN.
- **Intensifikimi i komunikimit dhe ndërgjegjësisë të konsumatorëve**, me synim rritjen e rolit të tyre ndërveprues në marrëdhënie me ofruesit e shërbimit dhe pjesëmarrjen aktive në proceset konsultative.
- **Vijimi i trajtimit efektiv të ankesave të konsumatorëve**, përmes mekanizmave të ankimit dhe strukturës së ngritur për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve.
- **Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me rregullatorët evropianë dhe institucionet partnere**, për shkëmbimin e praktikave më të mira rregullatore.
- **Forcimi i kapaciteteve profesionale të stafit**, përmes programeve të trajnimit kombëtar dhe ndërkombëtar dhe bashkëpunimeve bilaterale.

2.2 VEPRIMTARIA RREGULLATORE DHE MONITORUESE

Ky kapitull paraqet në mënyrë të strukturuar ushtrimin e funksioneve themelore të ERRU-së gjatë vitit 2025, në drejtim të licencimit, rregullimit tarifor dhe monitorimit të performancës së shoqërive ujësjellës-kanalizime. Në këtë kuadër, analizohen vendimmarrjet e Komisionit Kombëtar Rregullator, ecuria e aplikimeve për tarifa, si dhe rezultatet e monitorimit teknik dhe financiar të sektorit. Përmes këtij kapitulli evidentohet roli i ERRU-së në garantimin e zbatimit të kuadrit ligjor, forcimin e qëndrueshmërisë financiare të operatorëve dhe mbrojtjen e interesit të konsumatorëve.

2.2.1 Licencimi i Operatorëve UK gjatë vitit 2025

– Kuadri ligjor për licencimin

Procesi i licencimit përbën një nga instrumentet themelore rregullatore për garantimin e funksionimit të ligjshëm dhe të qëndrueshëm të sektorit. Përmes këtij procesi sigurohet që subjektet të cilët ushtrojnë veprimtari në sektor të përmbushin kriteret teknike, financiare dhe ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Në këtë kuadër, në nenin 15 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, përcaktohet detyrimi i çdo personi fizik dhe juridik që ushtron veprimtari në fushën e grumbullimit, shpërndarjes, largimit dhe trajtimit të ujit për përfitim publik, për t’u pajisur me licencë nga ERRU.

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, referuar pikës 1/a, 1/b dhe 1/i të nenit 14 të ligjit nr. 8102, KKRR, si organ vendimmarrës i ERRU-së, ushtron kompetencat për dhënien e licencave për entet që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, përcaktimin e tarifave të licencimit, si dhe miratimin e rregullave dhe procedurave të nevojshme për ushtrimin e këtyre funksioneve.

Procesi i licencimit të shoqërive ujësjellës-kanalizimeve realizohet në përputhje me VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe me Rregulloren e Licencimit, miratuar me vendimin e KKRR nr. 29, datë 08.12.2009, e ndryshuar. Ky kuadër nënligjor përcakton kriteret, dokumentacionin dhe procedurat që duhet të përmbushin subjektet për dhënien, rinovimin ose ndryshimin e licencës.

– Aplikime për licencim

Gjatë vitit 2025, pesë shoqëri ujësjellës-kanalizime kanë paraqitur pranë ERRU-së kërkesa për licencim, rinovim ose ndryshim licence, në përputhje me detyrimet ligjore dhe kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Këto aplikime lidhen kryesisht me përfundimin e afatit të licencës ose me ndryshime në drejtimin teknik dhe ligjor të shoqërive, siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.1 Tipologjitë e aplikimeve

Nr. rend.	Shoqëritë që kanë aplikuar në vitin 2025	Tipologjia e aplikimit / licencimit			
		Rinovim të licencës pas përfundimit të afatit	Ndryshim të Drejtuesit Ligjor	Ndryshim të Drejtuesit Teknik	Vendimmarrja e KKRR
1	Shoqëria Rajonale UK Fier (nëntor 2025)	✓	✓		Miratuar
2	Shoqëria Rajonale UK Durrës		✓	✓	Miratuar
3	Shoqëria Rajonale UK Fier (dhjetor 2025)		✓		Miratuar
4	Shoqëria Rajonale UK Tiranë		✓		Miratuar
5	Shoqëria Rajonale UK Vlorë		✓		Miratuar
6	Shoqëria UK Kamëz		✓		Nuk është miratuar

– Vendimmarrjet e Komisionit Kombëtar Rregullator

ERRU ka marrë në shqyrtim të gjitha aplikimet e paraqitura për licencim apo rinovim licence. Nga këto, aplikimet për 4 shoqëri janë paraqitur për vendimmarrje dhe janë miratuar nga KKRR. Ndërsa Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Kamëz nuk është trajtuar, për shkak të mos plotësimit të dokumentacionin sipas kërkesave ligjore.

SHRUK Fier, referuar dokumentacionit të paraqitur dhe plotësimit të kushteve dhe kriterëve është pajisur me licencë me afat të rinovuar dhe drejtues ligjor të ndryshuar, me vendim të datës 20.11.2025 për ofrimin e shërbimit për **Kategorinë A – grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik** dhe **Kategorinë C – largimi i ujërave të ndotura**. Kjo shoqëri ofron shërbimin në **bashkitë Fier, Patos, Roskovec dhe Mallakastër**.

Për këtë aplikim, me qëllim mos ndërprerjen e veprimtarisë së shoqërisë, si edhe duke konsideruar procesverbalet dhe vendimet përfundimtare të inspektimeve përkatëse, të cilat ishin pjesë e aplikimit, KKRR vendosi licencimin me kusht, me një vlefshmëri licence 2-vjeçare, brenda të cilit shoqëria duhet të përfundojë e të paraqesë akt-miratimin higjieno-sanitar për njësinë Patos.

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të aplikimit për ndryshimin përsëri të drejtuesit ligjor të saj, KKRR vendosi në dhjetor të vitit 2025, miratimin e licencës me këtë ndryshim.

SHRUK Durrës është e vetmja shoqëri që zotëron licencë për të katërta kategoritë si: **Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik**, **Kategoria B - Për përpunimin e ujit për konsumim publik**, **Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura** dhe **Kategoria D - Për përpunimin e ujërave të ndotura**.

Aplikimi i saj për një ndryshim në vendimin e licencës përkatëse, si pasojë e ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesve teknikë, pas verifikimit të dokumentacionit administrativ dhe profesional, si edhe

duke konstatuar përmbushjen e kriterëve të kualifikimit për pozicionet drejtuese, **KKRR** miratoi përditësimin e drejtuesve.

SHUK Tiranë, paraqiti aplikimin për përditësimin e licencës ekzistuese, si pasojë e ndryshimit të drejtuesit ligjor.

Shoqëria vijon të ofrojë shërbimin për **Kategorinë A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik**, **Kategorinë B - Për përpunimin e ujit për konsumim publik**, **Kategorinë C - Për largimin e ujërave të ndotura**, në territorin e Bashkisë Tiranë.

Në kuadër të aplikimit, u verifikua dokumentacioni administrativ dhe profesional, si dhe përmbushja e kriterëve të kualifikimit, dhe si konkluzion ERRU miratoi ndryshimin përkatës në vendimin e licencimit.

SHRUK Vlorë paraqiti aplikimin për përditësimin e licencës ekzistuese, si pasojë e ndryshimit të drejtuesit ligjor. Shoqëria vijon të ofrojë shërbimin për **Kategorinë A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik dhe Kategorinë C - Për largimin e ujërave të ndotura**.

Në kuadër të aplikimit u verifikua dokumentacioni administrativ dhe profesional i paraqitur nga shoqëria, si dhe përmbushja e kriterëve për drejtuesin ligjor dhe pas vlerësimit, ERRU miratoi ndryshimin përkatës në vendimin e licencimit.

Në përfundim, gjatë vitit 2025, të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime që operojnë në sektor kanë ushtruar veprimtarinë e tyre të pajisura me licencë të vlefshme nga ERRU, duke garantuar respektimin e plotë të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

— Analizë krahasuese e aplikimeve për licencim në periudhën 2023-2025

Një vështrim krahasues i aplikimeve për licencim dhe rinovim licence në tre vitet e fundit evidenton një rënie progresive të numrit të tyre, e lidhur kryesisht me përfundimin e procesit të riorganizimit të shoqërive UK. Gjatë vitit 2023 janë paraqitur gjithsej 16 aplikime, duke reflektuar intensitetin e procesit të riorganizimit të shoqërive në subjekte me kompetenca të përbashkëta (SKP). Nga këto, 11 aplikime kanë qenë për licencim për herë të parë si SKP, 1 aplikim për përfundim afati licence, 3 aplikime për shkak të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe 1 aplikim për ndryshim të drejtuesit teknik.

Në vitin 2024 numri i aplikimeve është reduktuar në 8, nga të cilat 1 aplikim për licencim për herë të parë si SKP, 2 aplikime për përfundim afati licence, 3 aplikime për ndryshim të drejtuesit ligjor, 1 aplikim për ndryshim të drejtuesit teknik dhe 1 aplikim për ndryshim të drejtuesit ligjor dhe teknik njëkohësisht.

Gjatë vitit 2025 janë paraqitur 6 aplikime, konkretisht 1 aplikim për përfundim afati licence, 3 aplikime për shkak të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe 2 aplikime për shkak të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik njëkohësisht.

Analiza e strukturës së aplikimeve tregon se, pavarësisht uljes së numrit total të tyre, ndryshimet në nivelet drejtuese përbëjnë një nga arsyt më të shpeshta të aplikimeve gjatë periudhës në shqyrtim. Në këtë kuadër, vlerësohet e rëndësishme forcimi i stabilitetit menaxherial në shoqëritë UK, si një

faktor që kontribuon në përmirësimin gradual të performancës dhe në qëndrueshmërinë afatgjatë të shërbimeve.


2.2.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor në Sektor

– Kuadri rregullator dhe metodologjik për miratimin e tarifave

Procesi i rregullimit tarifor në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve kërkon një qasje të strukturuar dhe të unifikuar, me qëllim garantimin e transparencës, objektivitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK. Në kushtet e reformës së sektorit dhe nevojës për kalimin drejt një modeli më të konsoliduar rajonal u bë e domosdoshme përcaktimi i një metodologjie të qartë që të standardizonte mënyrën e përlllogaritjes dhe miratimit të tarifave.

Më poshtë tregohet në formë skematike, procedura që aplikohet për miratim të nivelit tarifor.

Figura nr. 1 Procedura e aplikimit për miratim të nivelit tarifor



Në këtë kuadër, ERRU miratoi dokumentin “Metodologjia dhe Procedura për Miratimin e Tarifave të Shërbimeve Ujësjellës-Kanalizime”, me vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021, në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.06.1998, i ndryshuar. Metodologjia përcakton rregullat, parimet dhe procedurat që ndiqen në analizimin dhe miratimin e tarifave, duke siguruar një balancë të qëndrueshme ndërmjet përballueshmërisë për konsumatorët dhe mbulimit të kostove reale të shërbimit nga operatorët. Për herë të parë kjo metodologji sjell dhe konceptin e periudhës rregullatore në procesin tarifor.

Përmes kësaj metodologjie, procesi tarifor është bërë më i strukturuar, i bazuar në të dhëna të verifikueshme dhe në objektiva të matshëm performance, duke forcuar rolin rregullator të ERRU-së dhe transparencën në vendimarrje.

– Faktorët ligjorë, institucionalë dhe ekonomik që kanë diktuar aplikimet për tarifa të reja

Aplikimet/miratimet për nivel të ri tarifor të paraqitura nga shoqëritë rajonale gjatë periudhës së raportimit, janë diktuar nga një kombinim faktorësh ligjorë, institucionalë, ekonomik dhe rregullator, të lidhur ngushtë me procesin e reformës së sektorit, me kërkesat e metodologjisë së tarifave dhe me kalimin drejt një qasjeje më të strukturuar të vendimmarrjes tarifore, të bazuar në periudha rregullatore. Vlen të theksohet se:

- Aplikimet lidhen drejtpërdrejt me detyrimin ligjor të shoqërive UK për të ofruar shërbime vetëm me tarifa të miratuara nga ERRU, në përputhje me nenin 14 të ligjit nr. 8102, datë 28.06.1998 “Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të FU dhe KUN”, i ndryshuar, i cili e përcakton ERRU si autoritetin e vetëm kompetent për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime. Në këtë kuptim, aplikimi për tarifa të reja përbën një kusht të domosdoshëm për ushtrimin ligjor të veprimtarisë së operatorëve;
- Detyrimi për respektimin e periudhës rregullatore dhe aplikimin pas përfundimit të saj. Sipas nenit 11 të metodologjisë, periudha rregullatore është periudha gjatë së cilës ERRU përcakton planin tarifor, objektivat e performancës dhe parametrat kryesorë të funksionimit të shoqërisë, pas përfundimit të së cilës shoqëria UK është e detyruar të aplikojë për tarifa të reja. Mosaplikimi për tarifa pas përfundimit të periudhës rregullatore përbën shkak për masa administrative sipas ligjit nr. 8102, e njëkohësisht kjo shoqëri nuk ka një tarifë të cilën mund ta aplikojë tek përdoruesit e shërbimit. Në këtë kuadër, një pjesë e aplikimeve për tarifa të reja gjatë vitit 2025 janë diktuar jo vetëm nga nevoja ekonomike, por edhe nga detyrimi rregullator për të respektuar ciklin tarifor dhe për të hyrë në një periudhë të re rregullatore, në përputhje me vendimet e mëparshme të KKRR për tarifatat dhe afatet e tyre të vlefshmërisë;
- Aplikimet për tarifa të reja burojnë nga detyrimet ligjore të përcaktuara në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i cili parashikon unifikimin gradual të tarifave për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërive rajonale, si pjesë e konsolidimit institucional dhe financiar të operatorëve të rinj rajonalë. Në këtë kuadër, rishikimi i tarifave përbën një hap të domosdoshëm për zbatimin praktik të reformës dhe për harmonizimin e niveleve tarifore brenda të njëjtës zone shërbimi;
- Aplikimet për tarifa të reja janë motivuar edhe nga nevoja për përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8102, i cili parashikon mbulimin e plotë të kostove operative si objektivi për funksionimin e qëndrueshëm të shërbimeve. Rritja e të ardhurave përmes tarifave synon të mundësojë mbulimin e kostove të mirëmbajtjes së rrjeteve, funksionimin e stacioneve të pompimit, rinovimin e pajisjeve dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit, duke krijuar bazën për përmirësim gradual të cilësisë së tij;
- Rol të rëndësishëm në nevojën për rishikim tarifor kanë luajtur zhvillimet në strukturën e kostove gjatë vitit 2025, veçanërisht rritja e çmimeve të energjisë elektrike për shoqëritë që operojnë sipas skemave me ngritje mekanike, rritja e kostove të materialeve dhe ndikimi i rritjes së pagës minimale në shkallë vendi. Këta faktorë kanë ushtruar presion të drejtpërdrejtë mbi kostot operative të shoqërive UK, duke e bërë të domosdoshme përafrimin e tarifave me kostot reale të shërbimeve dhe rishikimin e parashikimeve financiare për periudhën rregullatore në vijim.

– Aplikimet për tarifa gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, pranë ERRU-së paraqitën aplikim për tarifa dy shoqëri rajonale, përkatësisht:

- **SHRUK Kukës** - aplikon për herë të parë si shoqëri rajonale;
- **SHRUK Lezhë** - aplikon për tarifa të reja, në mbyllje të periudhës rregullatore.

Duke marrë në konsideratë kërkesat për shtyrje afati të paraqitura nga shoqëritë dhe arsyetimet përkatëse lidhur me situatën institucionale dhe administrative, KKRR vendosi shtyrjen e afatit të aplikimit deri më 30 shtator 2025. Në përfundim të këtij afati, KKRR mori vendim:

- **SHRUK Kukës** - refuzim aplikimi për mosplotësim dokumentacioni (*referur nenit 10 të metodologjisë së tarifave*);
- **SHRUK Lezhë** - fillimin e procedurës së analizës për aplikimin për nivel të ri tarifar.

– Vendimet e miratuara nga KKRR gjatë vitit 2025 për trajtimin e aplikimit për tarifa

Në vitin 2025 u trajtuan aplikime të cilat kishin filluar procedurën gjatë vitit 2024 dhe për të cilat u morën vendimet përfundimtare për 3 shoqëri rajonale, përkatësisht SHRUK Korçë, Elbasan dhe Berat. Ndërkohë është ende në proces të analizës tekniko-ekonomike SHRUK Lezhë, për të cilën është parashikuar që vendimi për miratimin e tarifave të finalizohet brenda 6 mujorit të parë të vitit 2026.

Tabela nr.2 Shoqëritë për të cilat KKRR ka marrë vendim për miratim tarife dhe fillim procedure

Nr.	SHRUK	Nr. vendimi KKRR	Datë Vendimi/Parashikimi	Statusi
1	Elbasan	18	01.07.2025	Miratuar
2	Korçë	19	01.07.2025	Miratuar
3	Berat	20	01.07.2025	Miratuar
4	Lezhë		Qershor 2026*	Proces

**SHRUK Lezhë është në proces trajtimi të aplikimit*

Tabela më sipër paraqet në mënyrë të përmblendhur vendimmarrjen e KKRR-së, lidhur me tarifat, për vitin 2025.

Vlen të theksohet se, projektvendimet për miratimin e tarifave, përpara se të marrin formë përfundimtare nga ERRU, dërgohen për komente pranë shoqërive UK, bashkitë përkatëse, AKUK si edhe tek Autoriteti i Konkurrencës.

– Metodat e përcaktimit të tarifave dhe pozicionimi i shoqërive

Metodologjia e tarifave parashikon dy metoda aplikimi, si më poshtë:

- metodën “**kosto plus**” për shoqëritë që nuk mbulojnë mbi 100% kostot operative;
- metodën “**çmimi tavan**” për shoqëritë që arrijnë të mbulojnë mbi 100% të kostove të O&M dhe kanë synim të mbulojnë kostot totale.

Shoqëritë që janë pajisur me tarifa përgjatë vitit 2025, përkatësisht **SHRUK Elbasan** dhe **SHRUK Berat** kanë aplikuar me metodën “**kosto plus**” pasi bëjnë pjesë në grupin e shoqërive që *nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M mbi 100%*. Ndërsa **SHRUK Korçë** ka aplikuar me metodën “**çmim tavan**”, pasi

bënë pjesë në grupin e shoqërive që arrijnë të mbulojnë kostot e O&M mbi 100%. Kjo është shoqëria e parë në sektor që ka aplikuar sipas metodës “çmimi tavan”. Zbatimi i kësaj metode mundëson planifikimin që me anë të tarifave të mbulohen pjesërisht ose tërësisht nevojat për investime fizike në të ardhmen, por pa cenuar kriterin e përballueshmërisë nga klientët të pagesës së faturës së shërbimeve UK.

– Analiza për tarifat e miratuara

SHRUK Korçë ka aplikuar për herë të parë në qershor 2024, pas licencimit si shoqëri me kompetenca të përbashkëta (SKP), në zbatim të VKM nr. 302, me qëllim unifikimin e tarifave fikse për të gjitha kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit, si dhe unifikimin e tarifave volumetrike për dy zonat e shërbimit për një periudhë 5-vjeçare.

Shoqëria përbëhet nga njësitë Korçë, Maliq, Devoll, Kolonjë dhe Pustec. Njësia Pustec nuk ka pasur tarifa të miratuara nga ERRU, por nga Këshilli Bashkiak. Gjithashtu, zona të caktuara të njësive Korçë dhe Maliq, si dhe plotësisht njësitet Devoll dhe Pustec, nuk kanë pasur tarifa të miratuara për shërbimin e kanalizimeve (KUN).

Me tarifat e miratuara nga KKRR, parashikohet mbulim i kostove operative (O&M) për periudhën 2025–2029 përkatësisht në nivelet 133.6%, 129.8%, 127.6%, 124.5% dhe 122.8%, ndërsa mbulimi i kostove totale parashikohet në nivelet 32.4%, 31.2%, 30.9%, 30.7% dhe 30.5%. Këto tarifa synojnë përmirësimin gradual të performancës financiare të shoqërisë dhe rritjen e të ardhurave, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë financiare në periudhën afatmesme.

Tabela më poshtë paraqet analizën e një komponenti të rëndësishëm të vlerësimit tekniko-ekonomik, konkretisht përballueshmërinë e faturës për konsumatorët familjarë.

Tabela nr.3 Përballueshmëria përgjatë periudhës rregullatore 2025-2029

Përballueshmëria e Faturës së Shërbimeve FU dhe KUN	Njësia	Zona A	Zona B				
		Njësia Korçë	Njësia Rurale Korçë	Njësia Maliq	Njësia Devoll	Njësia Kolonjë	Njësia Pustec
Kosto për shërbimet me TVSH	lekë/muaj	1,248	828	828	828	828	828
Shpenzimet mesatare mujore	lekë	83,864	83,864	83,864	83,864	83,864	83,864
Përballueshmëria e Faturës	%	1.5	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0

Referuar tabelës më sipër konstatohet se fatura mujore sipas variantit të dhënë nga ERRU për të gjithë konsumatorët familjarë është brenda kriterit të përballueshmërisë prej jo më shumë se 5% të shpenzimeve mesatare mujore.

Gjithashtu, më poshtë paraqitet krahasimi ndërmjet tarifave të propozuara nga **SHRUK Korçë** dhe tarifave aktuale të miratuara nga ERRU, sipas kategorive të klientëve dhe njësive përkatëse administrative. Nëpërmjet këtij krahasimi evidentohet niveli i kërkesës së shoqërive në raport me

vlerësimin rregullator, duke reflektuar procesin e analizës tekniko-financiare dhe aplikimin e metodologjisë së miratuar të tarifave. Diferencat midis tarifës së kërkuar dhe asaj të miratuar tregojnë balancimin e nevojës për mbulimin e kostove dhe sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të shërbimit, me detyrimin për të garantuar përbalueshmërinë dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Tabela nr.4 Kërkesa e shoqërisë/tarifa e miratuar

Kategoria e Klientëve	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU
	Njësia Korçë/Urbane		* Njësia Rurale Korçë		Njësia Maliq		*Njësia Devoll		Njësia Kolonjë		*Njësia Pustec	
A. Shërbimi i FU	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³
1. Klientë Familjarë	72	72	50	50	50	50	50	50	50	50	50	50
2. Klientë Publik	140	140	140	110	140	100	140	100	140	100	140	100
3. Klientë Privat	140	140	140	100	140	105	140	110	140	110	140	100
B. Shërbimi i KUN	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/muaj	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³
1. Klientë Familjarë	48	48	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20
2. Klientë Publik	80	80	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30
3. Klientë Privat	80	80	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30
C. Tarifë Fikse Shërbimi	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
1. Klientë Familjarë	200	200	200	200	200	200	200	200	200	200	200	200
2. Klientë Publik	200	200	200	200	200	200	200	200	200	200	200	200
3. Klientë Privat	200	200	200	200	200	200	200	200	200	200	200	200

SHRUK Elbasan ka aplikuar për herë të parë në qershor 2024 pas licencimit si SKP, në zbatim të VKM nr.302, me qëllim unifikimin e tarifave volumetrike dhe fikse për të gjithë kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit për *periudhën 3-vjeçare*. Kjo shoqëri është e përbërë nga njësitë Elbasan, Librazhd, Gramsh, Belsh, Cërrik dhe Peqin, nga të cilat njësia Belsh dhe Cërrik nuk kanë tarifë të miratuar nga ERRU por nga Këshillat Bashkiak përkatës. Ndërkohë, për shërbimin KUN, njësitë, Librazhd (rurale), Cërrik, Belsh dhe Gramsh kanë operuar pa tarifë shërbimi. Me tarifën e miratuar nga KKRR, parashikohet mbulim i kostove O&M për vitet 2025-2026-2027 përkatësisht me 78%, 88% dhe 83.6%.

Tabela më poshtë tregon analizimin e një komponenti shumë të rëndësishëm gjatë analizës tekniko ekonomike siç është përbalueshmëria.

Tabela nr.5 Përbalueshmëria përgjatë periudhës rregullatore 2025-2027

Përbalueshmëria e Faturës së Shërbimeve FU dhe KUN	Njësia	Zona A	Zona B				
		Njësia Elbasan	Njësia Librazhd Urbane+Rurale	Njësia Gramsh	Njësia Belsh	Njësia Cërrik	Njësia Peqin
Kosto për shërbimet me TVSH	lekë/muaj	1,176	1,176	1,176	1,176	1,176	1,176
Shpenzimet mesatare mujore	lekë	78,678	78,678	78,678	78,678	78,678	78,678
Përbalueshmëria e Faturës	%	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5

Referuar tabelës më sipër, fatura mujore sipas tarifave të miratuara nga ERRU për të gjithë konsumatorët familjarë për gjithë zonën është brenda kriterit të përbalueshmërisë prej jo më shumë se 5% të shpenzimeve mesatare mujore.

Tabela nr.6 Kërkesa e shoqërisë/tarifa e miratuar

Kategoria e Klientëve	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU
	Njësia Elbasan	Njësia Librazhd	**Njësia Gramsh		*Njësia Belsh		*Njësia Cërrik		Njësia Peqin			
A. Shërbimi i FU	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3
1. Klientë Familjarë	60	50	60	50	60	50	60	50	60	50	60	50
2. Klientë Publik	130	130	130	100	130	100	130	120	130	120	130	120
3. Klientë Privat	130	130	130	100	130	100	130	120	130	120	130	120
B. Shërbimi i KUN	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/muaj	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3
1. Klientë Familjarë	15	15	15	15	15	15	15	15	15	15	15	15
2. Klientë Publik	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30
3. Klientë Privat	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30
C. Tarifë Fikse Shërbimi	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
1. Klientë Familjarë	200	200	200	200	200	200	200	200	200	200	200	200
2. Klientë Publik	400	400	400	300	400	300	400	300	400	300	400	300
3. Klientë Privat	400	400	400	300	400	300	400	300	400	300	400	300

Më sipër paraqitet krahasimi ndërmjet tarifave të propozuara nga **SHRUK Elbasan** dhe tarifave aktuale të miratuara nga ERRU, sipas kategorive të klientëve dhe njësive përkatëse administrative. Nëpërmjet këtij krahasimi evidentohet niveli i kërkesës së shoqërive në raport me vlerësimin rregullator, duke reflektuar procesin e analizës tekniko-financiare dhe aplikimin e metodologjisë së miratuar të tarifave. Diferencat midis tarifës së kërkuar dhe asaj të miratuar tregojnë balancimin e nevojës për mbulimin e kostove dhe sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të shërbimit, me detyrimin për të garantuar përballueshmërinë dhe mbrojtjen e konsumatorëve

SHRUK Berat ka aplikuar për herë të parë në qershor 2024 pas licencimit si SKP në zbatim të VKM nr.302, me qëllim unifikim e tarifave në zonën e shërbimit, si dhe për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura për të gjithë klientët në zonën e shërbimit. Kjo shoqëri është e përbërë nga njësiti Berat, Dimal, Poliçan, Kuçovë dhe Skrapar, nga të cilat njësia Dimal ka qënë pa tarifa të miratuara nga ERRU. Ndërkohë njësia Dimal nuk ka patur tarifë fikse të shërbimit, ndërsa njësia Skrapar (rurale) ka operuar pa tarifë për shërbimin KUN dhe FU. Me tarifën e miratuara nga KKRR, parashikohet mbulim i kostove O&M për vitet 2025-2026-2027 përkatësisht 108.6%, 113.2%, 118.6%.

Tabela më poshtë tregon analizimin e një komponenti shumë të rëndësishëm gjatë analizës tekniko ekonomike, siç është përballueshmëria.

Referuar kësaj table, konstatohet se fatura mujore sipas tarifave të miratuara nga ERRU për të gjithë konsumatorët familjarë për gjithë zonën është brenda kriterit të përballueshmërisë prej jo më shumë se 5% të shpenzimeve mesatare mujore.

Tabela nr.7 Përbalueshmëria përgjatë periudhës rregullatore 2025-2027

Përbalueshmëria e Faturës së Shërbimeve FU dhe KUN	Njësia	Zona A	Zona B			
		Njësia Berat/Roshnik	Njësia Kuçovë	Njësia Dimal/Rurale	Njësia Poliçan	Njësia Skrapar
Kosto për shërbimet me TVSH	lekë/muaj	1,188	1,188	1,116	1,116	1,116
Shpenzimet mesatare mujore	lekë	78,678	78,678	78,678	78,678	78,678
Përbalueshmëria e Faturës	%	1.5	1.5	1.4	1.4	1.4


Gjithashtu, më poshtë paraqitet krahasimi ndërmjet tarifave të propozuara nga **SHRUK Berat** dhe tarifave aktuale të miratuara nga ERRU, sipas kategorive të klientëve dhe njësive përkatëse administrative. Nëpërmjet këtij krahasimi evidentohet niveli i kërkesës së shoqërive në raport me vlerësimin rregullator, duke reflektuar procesin e analizës tekniko-financiare dhe aplikimin e metodologjisë së miratuar të tarifave. Diferencat midis tarifës së kërkuar dhe asaj të miratuar tregojnë balancimin e nevojës për mbulimin e kostove dhe sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të shërbimit, me detyrimin për të garantuar përbalueshmërinë dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Tabela nr.8 Kërkesa e shoqërisë/tarifa e miratuar

Kategoria e Klientëve	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU	Tarifat e propozuara nga shoqëritë rajonale UK	Tarifat Aktuale të miratuara nga ERRU
	Njësia Berat	Njësia Kuçovë	Njësia Dimal	Njësia Poliçan	Njësia Skrapar					
A. Shërbimi i FU	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³
1. Klientë Familjarë	54	54	54	54	54	50	54	50	54	50
2. Klientë Publik	134	130	134	130	134	100	134	100	134	100
3. Klientë Privat	134	130	134	130	134	100	134	110	134	110
B. Shërbimi i KUN	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³
1. Klientë Familjarë	16	16	16	16	16	15	16	15	16	15
2. Klientë Publik	28	28	28	28	28	20	28	20	28	20
3. Klientë Privat	28	28	28	28	28	20	28	20	28	20
D. Tarifë Fikse Shërbimi	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
1. Klientë Familjarë	150	150	150	150	150	150	150	150	150	150
2. Klientë Publik	250	250	250	250	250	200	250	200	250	200
3. Klientë Privat	250	250	250	250	250	200	250	200	250	200

Për të ilustruar zbatimin e kriterit të përbalueshmërisë për vendimet e miratuara në 2025, e paraqet grafiku më poshtë:


Grafiku nr. 1 Përballueshmëria



Theksohet se në aplikimet për tarifa, kostot e secilit shërbim paraqiten në mënyrë të veçantë në modelin përkatës të aplikimit, me qëllim llogaritjen e saktë të nevojave për të ardhura dhe orientimin e tarifave drejt mbulimit të kostove reale të shërbimeve përkatëse. Në këtë kuadër, ERRU vlerëson performancën aktuale dhe të pritshme të shoqërive, duke përcaktuar gjithashtu objektiva për periudhën rregullatore, të cilat monitorohen në vijim të veprimtarisë së institucionit.

Në mënyrë të përmblodhur, aplikimet dhe miratimet e vendimeve për tarifa paraqiten si më poshtë:

Figura nr. 2 Përmbledhje



Gjatë analizës së propozimeve për tarifa të reja janë evidentuar nevoja për përmirësim në raportimin dhe përpunimin e disa të dhënave, veçanërisht në lidhje me numrin e lidhjeve të reja, vëllimet e planifikuara për faturim, elementët e bilancit të ujit, konsumin e energjisë elektrike dhe kostot e parashikuara për paga dhe sigurime. Në këtë kuadër, forcimi i sistemeve të informacionit dhe rritja e saktësisë së të dhënave vlerësohen si elementë mbështetës për një analizë tarifore sa më të plotë dhe të qëndrueshme.

2.2.3 Raporti i Monitorimit të Performancës së Shoqërive UK-Viti 2024

Në kuadër të detyrimeve ligjore dhe funksionale për monitorimin e sektorit, gjatë vitit 2025 ERRU ka hartuar dhe publikuar **Raportin Vjetor të Performancës së Shoqërive Ujësjiellës-Kanalizime për vitin 2024**. Ky raport përbën një nga produktet kryesore analitike dhe monitoruese të veprimtarisë së ERRU-së për vitin 2025. Dokumenti përfundimtar është publikuar në korrik 2025 dhe është hartuar mbi bazën e të dhënave ekonomiko-financiare dhe tekniko-operative të grumbulluara dhe të verifikuara nga sektori i monitorimit pranë ERRU-së.

Raporti i Performancës shërben si instrument analize, informimi dhe transparence për sektorin UK, duke ofruar një pasqyrë të detajuar të gjendjes së sektorit, të ecurisë së reformës së rajonalizimit dhe të performancës së secilës shoqëri, përmes krahasimit ndërmjet shoqërive (benchmarking) dhe krahasimit me vitet paraardhëse. Ai përfshin analizën e *Treguesve Kryesorë të Performancës* (TKP), rezultateve financiare, investimeve, besueshmërisë së të dhënave, si dhe progresit të reformës institucionale në sektor.

Rezultatet e raportit tregojnë se gjatë vitit 2024 sektori UK ka shënuar përmirësim në shumicën e treguesve kryesorë të performancës, veçanërisht në aspektin financiar. Mbulimi i kostove operative (O&M) në nivel sektori është rritur në 107.6%, ndërsa mbulimi i kostove totale ka arritur në 83.2%, duke reflektuar një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me vitin 2023. Gjithashtu, janë përmirësuar tregues si norma e arkëtimit korente, niveli i matjes, kohëzgjatja e furnizimit me ujë dhe mbulimi me shërbime kanalizimi, çka tregon rritje të cilësisë së shërbimit dhe të eficiencës operacionale.

Megjithatë, raporti evidenton se sektori vijon të përballet me sfida strukturore, ku treguesi i Ujit Pa të Ardhura (UPA) mbetet në nivel të lartë, rreth 61% në shkallë kombëtare, duke ndikuar në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive dhe në eficiencën e përdorimit të burimeve ujore. Gjithashtu, rritja e kostove të punës dhe varësia e disa shoqërive nga subvencionet e qeverisë qendrore mbeten çështje që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme në politikat tarifore dhe menaxheriale.

Raporti i Performancës për vitin 2024 analizon gjithashtu ndikimin e reformës së sektorit, duke evidentuar se procesi i rajonalizimit ka kontribuar në përmirësimin e disa treguesve të performancës dhe në rritjen e kapaciteteve menaxheriale të shoqërive. Në këtë kuadër, ERRU ka përdorur rezultatet e raportit për të orientuar vendimmarrjen tarifore, për vendosjen e objektivave të reja të performancës dhe për formulimin e rekomandimeve konkrete për shoqëritë UK, në drejtim të reduktimit të humbjeve, përmirësimit të eficiencës së energjisë, forcimit të sistemeve të raportimit dhe hartimit të Planeve 5-vjeçare të Biznesit dhe Planeve të Menaxhimit të Aseteve.

Në këtë kuadër, *Raporti i Performancës për vitin 2024*, i përfunduar dhe publikuar nga ERRU gjatë vitit 2025, përfaqëson një produkt të rëndësishëm të veprimtarisë rregullatore dhe monitoruese të institucionit. Ky raport, i cili bazohet në analizën e rreth **240 variablave të standardizuara** për gjenerim dhe raportim nga të gjitha shoqëritë që operojnë në sektor, konkludon me vlerësimin e **12 Treguesve Kryesorë të Performancës**, duke ofruar një pasqyrë të strukturuar dhe të krahasueshme të ecurisë së sektorit. Në këtë mënyrë, ai lidh procesin e monitorimit të performancës me vendimmarrjen tarifore

dhe me politikat e reformës së sektorit, duke shërbyer si bazë për orientimin e objektivave afatmesme në drejtim të qëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.

Në mënyrë të përmbledhur, treguesit e performancës sipas Raportit të Performancës për vitin 2024 paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 9 Treguesit Kryesor të Performancës

Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	Viti 2024	Treguesit e Përmirësuar
1	Uji Pa të Ardhura (%)	61	✓
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	107.6	✓
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	83.2	✓
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	102.6	
5	Norma e Arkëtimit Korente(%)	84.6	✓
6	Niveli i Matjes (%)	87.9	✓
7	Efienca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	4.43	✓
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	17.44	✓
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	57	✓
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	77.8	✓
11	Efienca e Energjisë FU (kwh/m ³)	0.66	✓
12	Ankesat e Klientëve (%)	4.64	

2.2.4 Bilanci i Ujit

Bilanci i Ujit përbën një nga instrumentet më të rëndësishme rregullatore dhe analitike të përdorur nga ERRU për monitorimin e performancës teknike dhe financiare të shoqërive ujësjellës-kanalizimeve. Ky instrument pasqyron në mënyrë të strukturuar raportin midis sasisë së ujit që hyn në sistem dhe asaj që gjeneron të ardhura, si dhe sasinë e ujit që humbet gjatë proceseve të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes, e njohur si Uji Pa të Ardhura (UPA).

Gjatë vitit 2025, është miratuar *Raporti Bilanci i Ujit për vitin 2024*, me Vendim nr. 34, datë 14.11.2025 të Komisionit Kombëtar Rregullator të Ujit (KKRR) “Për miratimin e raportit të bilancit të ujit për shoqëritë ujësjellës-kanalizimeve për vitin 2024”. Ky vendim formalizon rezultatet e analizës teknike dhe konfirmon përdorimin e Bilancit të Ujit si instrument rregullator për vlerësimin e performancës së shoqërive UK, monitorimin e humbjeve të ujit dhe orientimin e masave për përmirësimin e efencës së sistemeve të furnizimit me ujë.

Hartimi i *Bilancit të Ujit* bazohet në procesin vjetor të mbledhjes, verifikimit dhe përpunimit të të dhënave të raportuara nga 14 shoqëritë e rajonalizuara dhe 3 shoqëritë që vazhdojnë të operojnë sipas statusit të mëparshëm, duke iu nënshtruar një procesi analitik dhe krahasues për të siguruar koherencën dhe besueshmërinë e tyre.

Viti 2024 shënon vitin e 13-të radhazi që ERRU përgatit dhe publikon Raportin e Bilancit të Ujit, që prej miratimit të formatit standard me vendimin nr. 46, datë 27.12.2013 të Komisionit Kombëtar

Rregullator. Ky proces i vazhdueshëm shumëvjeçar ka mundësuar ndërtimin e një baze të qëndrueshme të dhënash sektoriale, e cila shërben jo vetëm për vlerësimin vjetor të performancës, por edhe si bazë teknike gjatë analizës së aplikimeve për tarifa dhe miratimin e programeve të investimeve.

Bilanci i Ujit për vitin 2024 është hartuar në përputhje me metodologjinë e Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA), duke respektuar unifikimin e terminologjisë dhe komponentëve përbërës për të gjitha shoqëritë UK. Në kushtet kur ndarja e rrjeteve në zona me matje të pavarura (DMA) mbetet ende e pazbatuar gjerësisht, përlllogaritja e nënkomponentëve të bilancit është realizuar sipas metodologjisë “nga lart-poshtë” (top-down), me fokus në përcaktimin e humbjeve të dukshme dhe në vijim, të humbjeve reale.

Analiza për vitin 2024 tregon se shërbimi i furnizimit me ujë mbulon rreth 77.8% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor i ujit arriti në rreth 302.8 milion m³, nga të cilat 64.8% është raportuar si sasi e matur dhe 35.2% si sasi e vlerësuar. Niveli i Ujit Pa të Ardhura (UPA) në rang sektori rezulton në rreth 61%, duke pasqyruar situatën aktuale të sektorit dhe progresin e arritur krahasuar me vitin paraardhës (Shih Aneksin 4).

Humbjet totale ndahen pothuajse në mënyrë të barabartë ndërmjet humbjeve reale (teknike) dhe humbjeve të dukshme (administrative). Humbjet reale lidhen kryesisht me rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes dhe amortizimin e infrastrukturës, ndërsa humbjet administrative vijnë nga lidhjet e paligjshme, pasaktësitë në matje dhe problematikat e faturimit. Konsumi i autorizuar i faturuar përbën rreth 39 % të ujit të prodhuar, duke reflektuar nevojën për përmirësim të mëtejshëm të menaxhimit të kërkesës dhe rritjes së eficiencës së sistemit të furnizimit me ujë.

ERRU vlerëson se puna analitike e kryer nga strukturat teknike të institucionit, përfshirë verifikimin e të dhënave, analizën e komponentëve përbërës të bilancit dhe identifikimin e problematikave për çdo shoqëri, përbën një element kyç të procesit rregullator. Rezultatet e Bilancit të Ujit shërbejnë si bazë për formulimin e rekomandimeve konkrete për shoqëritë UK, orientimin e planeve të biznesit, miratimin e programeve të investimeve dhe monitorimin e përmbushjes së objektivave për reduktimin e UPA-së.

ERRU thekson se hartimi i rregullt dhe i vazhdueshëm i Bilancit të Ujit, i mbështetur në një proces të strukturuar mbledhjeje dhe analize të të dhënave, mbetet një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë rregullatore të institucionit. Përmirësimi i cilësisë së raportimit nga shoqëritë UK dhe rritja e saktësisë së matjes në të gjitha nivelet e sistemit janë parakushte thelbësore për reduktimin e humbjeve, rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe garantimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë për qytetarët.

2.2.5 Metodologjia e Hartimit të Planit të Biznesit 5 Vjeçar

Në kuadër të zbatimit të metodologjisë së re të miratimit të tarifave dhe forcimit të lidhjes ndërmjet procesit tarifar, performancës së shoqërive dhe planifikimit afatmesëm të investimeve, gjatë vitit 2025, ERRU ka hartuar dhe miratuar *Modelin dhe Udhëzuesin e Planit të Biznesit 5-vjeçar* për shoqëritë ujësjellës kanalizime, si një instrument rregullator i detyrueshëm për aplikimet tarifore sipas metodës “Çmimi Tavan”. Ky dokument është përgatitur në përputhje me kërkesat e vendimit të KKRR nr. 539,

datë 30.12.2021 për metodologjinë e tarifave dhe përbën një produkt kyç të veprimtarisë së ERRU-së gjatë vitit 2025.

Hartimi i Modelit dhe Udhëzuesit të Planit të Biznesit është realizuar në kuadër të programit të modernizimit të sektorit UK, të mbështetur nga Banka Botërore dhe SECO, dhe është pjesë e përpjekjeve për zbatimin e reformës afatgjatë në sektor, në përputhje me Strategjinë Kombëtare Sektoriale 2023–2030. Në këtë kuadër, ERRU, në bashkëpunim me AKUK dhe me mbështetjen e asistencës teknike, ka zhvilluar një model të unifikuar, i cili synon të standardizojë planifikimin financiar, teknik dhe investues të shoqërive rajonale UK.

Plani i Biznesit përbëhet nga një strukturë e detajuar narrative dhe nga një fletë të dhënash në format excel, ku shoqëritë duhet të raportojnë të dhëna faktike dhe parashikime për: *treguesit kryesorë të performancës (TKP), asetet, huatë, kostot operative, kostot e investimit, kostot e kapitalit, të ardhurat e nevojshme, vëllimet e shërbimeve, numrin e konsumatorëve, strukturën tarifore dhe përballueshmërinë e faturës familjare*. Kjo qasje mundëson lidhjen e drejtpërdrejtë të tarifave me nevojat reale financiare dhe objektivat e performancës së shoqërive.

Një element thelbësor i *Planit të Biznesit 5 vjeçar*, është përfshirja e mekanizmit të korrigjimit për përballueshmërinë, i cili siguron që fatura mesatare familjare të mos tejkalojë pragun prej 5% të të ardhurave ose shpenzimeve mujore të njësisë ekonomike familjare, në përputhje me kriteret sociale të përcaktuara në metodologjinë e tarifave. Ky mekanizëm forcon balancën ndërmjet qëndrueshmërisë financiare të shoqërive dhe mbrojtjes së konsumatorëve.

Plani i Biznesit shërben gjithashtu si bazë për vendosjen e objektivave të performancës gjatë periudhës rregulatore, për monitorimin vjetor të progresit dhe për aplikimin e mekanizmave të bonusit ose penaltetit në procesin tarifar. Në këtë mënyrë, dokumenti krijon një lidhje të strukturuar ndërmjet tarifave, investimeve, përmirësimit të shërbimit dhe përgjegjshmërisë së operatorëve ndaj objektivave të miratuara nga ERRU.

Në përfundim, Modeli dhe Udhëzuesi i Planit të Biznesit përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt kalimit nga një qasje vjetore dhe reaktive e rregullimit tarifar, në një qasje të bazuar në planifikim afatmesëm, objektiva të matshme performance dhe integrim të investimeve në strukturën tarifore, duke përforcuar rolin rregullator të ERRU-së dhe duke mbështetur zbatimin efektiv të reformës së sektorit UK.

2.3 MBROJTJA E KONSUMATORËVE

Mbrojtja e konsumatorit përbën një nga **prioritetet kryesore të veprimtarisë së ERRU-së**, me synimin për të garantuar cilësi, transparencë dhe siguri në ofrimin e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, duke ruajtur njëkohësisht balancën me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK.

Instrumentet kryesore që përdoren për mbrojtjen e konsumatorëve janë:

- **monitorimi i respektimit të kushteve të licencës** nga shoqëritë UK, përfshirë standardet teknike dhe detyrimet kontraktuale;

- **miratimi i tarifave të shërbimit**, proces i cili përfshin detyrimisht *konsultimin publik* përmes seancave dëgjimore dhe *vlerësimin e respektimit të kufirit të përballueshmërisë* së faturës së shërbimeve.

Gjatë vitit 2025 janë miratuar tarifa për tre shoqëri rajonale, përkatësisht SHRUK Korçë, Elbasan dhe Berat, për të cilat janë zhvilluar dhe dokumentuar dëgjesa publike në njësitë përkatëse të juridiksionit. Në këtë proces janë shprehur gjithashtu edhe *këshillat e njërive të vetëqeverisjes vendore*, duke forcuar **transparencën** dhe **përfshirjen institucionale** në vendimmarrje.

Përveç instrumenteve të mësipërme, ERRU ka vijuar të forcojë informimin dhe transparencën, duke rritur ndërgjegjësimin e konsumatorëve mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe mbi kushtet e ofrimit të shërbimit.

Një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve zë trajtimi i ankesave, i cili garanton ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë vitit 2025, ERRU ka vijuar administrimin dhe shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga konsumatorët kundrejt shërbimeve UK, duke ushtruar rolin e hallkës së dytë administrative në këtë proces.

Në këtë kuadër, ERRU ka verifikuar **kriteret formale** dhe **ligjore** për pranimin e ankesave, duke u siguruar që ato të lidhen me shoqëri të licencuara dhe të shoqërohen me dokumentacionin përkatës. Më pas, ankesat janë adresuar pranë shoqërive UK për marrjen e informacionit plotësues dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për zgjidhjen e tyre.

Ankesat janë paraqitur nga konsumatorë familjarë, privatë dhe publikë që përfitojnë shërbim nga shoqëri të ndryshme në vend. Një pjesë e tyre janë deleguar nga institucione si Avokati i Popullit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve, duke reflektuar besimin institucional ndaj rolit ndërmjetësues të ERRU-së. Krahas shkresave zyrtare, konsumatorët kanë përdorur gjerësisht kanalet elektronike të komunikimit, si postën elektronike, telefon dhe rubrikën “*Bëj një ankesë*” në faqen zyrtare të ERRU-së – e cila ka shënuar rritje gjatë vitit.

Natyra e ankesave ka qenë e larmishme, duke përfshirë raste të mbi faturimit, problematika mbi cilësinë e shërbimit, mosrespektim të kushteve kontraktuale dhe çështje teknike. Rastet e mbi faturimit kanë qenë më të shpeshta, për të cilat ERRU ka rekomanduar korigjimin e faturimit sipas konsumit real dhe marrjen e masave parandaluese. Ankesat për cilësinë e shërbimit kanë reflektuar shqetësime lidhur me problematika teknike dhe vonesa në përgjigje nga shoqëritë UK, duke kërkuar në disa raste edhe verifikime në terren. Pjesa më e madhe e ankesave është përmbyllur gjatë vitit 2025, ndërsa një numër i kufizuar mbetet në proces për trajtim gjatë vitit 2026.

ERRU ka përcaktuar ndër Treguesit Kryesorë të Performancës indikatorin “**Ankesat e Klientëve**”, i cili lidhet drejtpërdrejt me nivelin e angazhimit të shoqërive në trajtimin e kërkesave të konsumatorëve. Monitorimi i këtij treguesi për vitin 2025 ka evidentuar nevojën për forcimin dhe unifikimin e procedurave të brendshme të trajtimit të ankesave, me qëllim rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimit ndaj konsumatorëve.

2.4 TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET E ERRU-SË ME PUBLIKUN DHE MEDIAN

Në vitin 2025, ERRU ka orientuar komunikimin publik drejt forcimit të transparencës institucionale dhe garantimit të një informimi të saktë, të plotë dhe të aksesueshëm për konsumatorët, në një fazë kur reforma në sektor vijon të zbatohet dhe të zhvillohet. Ky angazhim ka synuar **rritjen e besimit të publikut dhe forcimin e rolit të ERRU-së** si institucion rregullator i pavarur dhe referues në sektor.

Marrëdhënia e ERRU-së me median është ndërtuar mbi rolin e institucionit si burim referues dhe i besueshëm informacioni, përmes publikimit të të dhënave, vendimeve dhe raporteve zyrtare mbi gjendjen e sektorit. Gjatë vitit 2025, gjetjet kryesore të Raportit Vjetor dhe Raportit të Performancës, si dhe vendimmarrjet e Komisionit Kombëtar Rregullator të Ujit, janë pasqyruar në media televizive dhe online, duke kontribuar në informimin e publikut mbi **performancën e shoqërive ujësjellës-kanalizime, zhvillimet tarifore dhe ecurinë e reformës**. Ky pasqyrim ka ndihmuar në ruajtjen e koherencës ndërmjet komunikimit institucional dhe atij mediatik.

Vendimet e KKRR-së, veçanërisht ato që lidhen me tarifat, licencimet dhe aktet rregullatore, janë bërë publike në kohë reale në faqen zyrtare të ERRU-së, së bashku me dokumentacionin shoqëruar, duke garantuar **akses të plotë për publikun dhe palët e interesuara**.

Në drejtim të transparencës ndaj qytetarëve, gjatë vitit 2025 ERRU ka trajtuar kërkesat për informacion në përputhje me afatet ligjore, si dhe ka përditësuar periodikisht Regjistrin e “*Kërkesave dhe Përgjigjeve*”. Informacioni me interes publik ka qenë i aksesueshëm përmes “*Programit të Transparencës*”, në zbatim të detyrimeve ligjore për informimin e publikut.

Për të forcuar komunikimin me konsumatorët dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi rolin rregullator të institucionit, gjatë vitit 2025 ERRU ka nisur një **fushatë informimi mbi të drejtat dhe detyrimet** që burojnë nga Kontrata e Shërbimeve ndërmjet konsumatorëve dhe shoqërive UK.

Njëkohësisht, ERRU ka vijuar përdorimin e rrjeteve sociale, duke shpërndarë në mënyrë të strukturuar informacion mbi veprimtarinë institucionale përmes Buletinit Informativ me periodicitet tremujor. Transparenca dhe llogaridhënia ndaj publikut kanë mbetur një prioritet i qëndrueshëm, përmes publikimit të rregullt dhe të plotë të informacionit me interes për konsumatorët dhe për sektorin.

2.5 BASHKËPUNIMI DHE MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE

Gjatë vitit 2025 është vijuar forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe partnerët strategjikë, me synim përmirësimin e koordinimit institucional dhe rritjen e efektivitetit rregullator në sektorin. Veprimtaria në këtë drejtim është fokusuar në shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira, si dhe në mbështetjen e proceseve të zhvillimit dhe modernizimit të sektorit. Angazhimi është reflektuar përmes pjesëmarrjes aktive në konferenca, aktivitete institucionale, teknike dhe shkencore, si dhe përmes bashkërendimit të vazhdueshëm me aktorët kyç të sektorit, në funksion të forcimit të standardeve të mbikëqyrjes dhe rritjes së kapaciteteve rregullatore.

2.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare

– Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

Në zbatim të detyrimeve ligjore dhe në kuadër të ushtrimit të funksionit të tij si institucion i pavarur rregullator, ERRU ka vijuar gjatë vitit 2025 bashkëpunimin me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në funksion të rolit mbikëqyrës të organit legjislativ.

ERRU e vlerëson rolin e Kuvendit si një mekanizëm thelbësor të llogaridhënies institucionale dhe transparencës, duke konsideruar raportimin periodik dhe komunikimin me strukturat parlamentare si pjesë integrale të përgjegjshmërisë së tij publike. Përmes këtij bashkëpunimi, sigurohet informimi i plotë dhe i strukturuar i organit legjislativ mbi zhvillimet në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, ecurinë e reformës, vendimarrjet rregullatore dhe sfidat kryesore të sektorit.

Gjatë vitit 2025, përfaqësues të ERRU-së kanë marrë pjesë në seanca raportimi dhe takime pune në Kuvend, si dhe në mbledhjet e komisioneve parlamentare ku institucioni është thirrur për të paraqitur informacion dhe për të dhënë sqarime lidhur me veprimtarinë e tij. Raportimet janë zhvilluar pranë Komisionit për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm si dhe Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale.

Ky bashkëpunim ka kontribuar në forcimin e dialogut institucional dhe në konsolidimin e praktikave të llogaridhënies, duke mbështetur një qasje të qëndrueshme dhe transparente në rregullimin e sektorit.

– Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizime (AKUK)

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), gjatë vitit 2025 është vijuar zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura më herët ndërmjet dy institucioneve. Ky bashkëpunim është fokusuar kryesisht në zhvillimin dhe konsolidimin e instrumenteve të planifikimit dhe monitorimit në sektorin.

Një ndër rezultatet kryesore të këtij bashkëpunimi ka qenë hartimi i Modelit dhe Udhëzuesit të Planit të Biznesit 5-vjeçar për shoqëritë ujësjellës-kanalizime, i miratuar nga ERRU, i cili shërben si dokument i unifikuar për planifikimin afatmesëm financiar dhe operacional të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Ky instrument kontribuon në rritjen e standardizimit dhe koherencës së planifikimit në nivel sektorial.

Paralelisht, ERRU dhe AKUK kanë bashkëpunuar në funksion të Sistemit të Integruar të të *Dhënave dhe Treguesve Kryesorë të Performancës* (IPIS), duke zhvilluar shkëmbim të vazhdueshëm informacioni për përmirësimin e cilësisë së raportimit dhe harmonizimin e të dhënave të performancës së shoqërive UK. Ky bashkërendim ka mbështetur proceset rregullatore dhe vendimmarrëse në sektor.

Gjatë vitit 2025, ERRU ka marrë pjesë gjithashtu në tryeza dhe aktivitete të organizuara nga AKUK, përfshirë aktivitetet mbi forcimin e sistemeve të monitorimit dhe raportimit për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në Shqipëri, duke kontribuar me ekspertizën e tij rregullatore në këto procese.

ERRU e konsideron bashkëpunimin me AKUK një partneritet të rëndësishëm institucional, që kontribuon në koordinimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.

– **Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)**

Në vijim të marrëdhënieve ndërinstytucionale në sektor, ERRU ka qenë e përfshirë edhe në bashkëpunimin me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, duke marrë pjesë në aktivitete dhe diskutime që lidhen me menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe koordinimin e politikave sektoriale në kuadër edhe të përafrimit të legjislacionit me akuis të Bashkimit Evropian. Ky bashkëpunim ka synuar harmonizimin e qasjeve institucionale dhe forcimin e kapaciteteve për mbrojtjen dhe përdorimin racional të burimeve ujore.

– **Autoriteti i Konkurrencës**

Marrëdhëniet me Autoritetin e Konkurrencës kanë vijuar në frymën e garantimit të konkurrencës së lirë dhe mbrojtjes së interesit publik në sektor. Në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit me AK, ERRU ka kërkuar vlerësim mbi vendimet e marra nga KKRR për nivel të ri tarifor të shoqërive Rajonale të Korçës, Elbasanit dhe Beratit. Ky proces siguron respektimin e standardeve të konkurrencës, mbrojtjen e interesit publik dhe forcon transparencën institucionale në vendimmarrjen e sektorit ujësjellës-kanalizime.

– **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP)**

ERRU ka vijuar bashkëpunimin me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke u angazhuar në aktivitete dhe tryeza diskutimi që synojnë forcimin e transparencës dhe zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit në funksion të rritjes së besimit publik dhe llogaridhënies institucionale. ERRU ishte pjesë e konferencës kombëtare mbi transparencën dhe integritetin evropian, si dhe takimin për promovimin dhe implementimin e ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, ku u prezantuan modelet e reja të transparencës, u diskutuan sfidat e zbatimit dhe u ofruan udhëzime praktike për institucionet qendrore dhe vendore.

– **Akademia e Shkencave të Shqipërisë**

Bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë ka synuar avancimin e njohurive teknike dhe shkencore në sektor, duke mbështetur vendimmarrjen dhe përmirësimin e praktikave profesionale të stafit. Ky bashkëpunim është konkretizuar përmes pjesëmarrjes në aktivitete që kanë trajtuar si ndikimin e rreziqeve gjeologjike dhe hidrogeologjike në funksionimin dhe qëndrueshmërinë e sektorit ashtu edhe menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, ERRU ka kontribuar me një abstrakt shkencor “Rregullimi dhe qëndrueshmëria e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në kushtet e rreziqeve hidrogeologjike” dhe prezantim mbi mekanizmat e forcimit të qëndrueshmërisë së sektorit, duke përdorur analizën e treguesve të performancës së shoqërive UK si instrument për vlerësimin e kapaciteteve operacionale përballë rreziqeve natyrore.

2.5.2 Bashkëpunimi me Organizmat Ndërkombëtare

ERRU ka vijuar të forcojë rolin e tij në arenën ndërkombëtare përmes pjesëmarrjes aktive dhe kontributit në organizimin e aktiviteteve në nivel rajonal dhe evropian. Gjatë këtij viti, fokusi ka qenë përafrimi i rregullatorit me standardet e Bashkimit Evropian, shkëmbimin e përvojave rregullatore dhe

rritjen e kapaciteteve institucionale. Përveç pjesëmarrjes në konferenca, forume dhe aktivitete, ERRU ka qenë bashkë organizatore me Shoqatën Evropiane të Rregullatorëve të Ujit (WAREG) të një cikli seminaresh në kuadër të Programit TAIEX të Komisionit Evropian, duke kontribuar drejtpërdrejt në konceptimin, organizimin dhe zhvillimin e takimeve me tematikë për vendet e zgjerimit të BE-së.

– **Anëtarësimi në organizmat Evropiane dhe Ndërkombëtare**

Si anëtare me të drejta të plota në WAREG, ERRU ka marrë pjesë gjatë vitit 2025 në të tri Asamblëtë e Përgjithshme si dhe Forumin Evropian mbi Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, ku janë diskutuar zhvillimet kryesore në rregullimin e shërbimeve të ujit në Evropë, Treguesit e Përbashkët të Performancës, qëndrueshmëria e sektorit në kohë krizash energjetike e klimatike, si dhe politikat tarifore dhe mjedisore. Në këto organizime, ERRU ka kontribuar me përvoja dhe qëndrime mbi situatën kombëtare, duke theksuar nevojën për forcimin e kapaciteteve dhe harmonizimin me direktivat e Bashkimit Evropian.

Po ashtu, në kuadër të Programit TAIEX të Komisionit Evropian, ERRU së bashku me WAREG ka zhvilluar dy seminare. I pari, në lidhje me metodologjitë e mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave, përcaktimin e Treguesve Kryesorë të Performancës dhe përdorimin e sistemeve të automatizuara të raportimit. Ndërsa seminari i dytë kishte në fokus instrumentet teknike dhe ekonomike për reduktimin e humbjeve të ujit dhe përcaktimin e tarifave në vendet e zgjerimit të BE.

– **Bashkëpunimi me Donatorë dhe Aktorë Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë**

Mbështetja e donatorëve ndërkombëtarë ka luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve institucionale të ERRU dhe në rritjen e pranisë së tij në dialogun rajonal dhe ndërkombëtar për sektorin. Përmes projekteve, programeve dhe aktiviteteve të financuara nga partnerët e huaj, ERRU ka përfituar asistencë teknike, shkëmbim përvojash dhe trajnime të specializuara, të orientuara drejt përmirësimit të qasjeve rregullatore dhe përafrimit me standardet evropiane.

Një rol të veçantë ka pasur Banka Botërore, përmes Programit të Danubit për Ujin, e cila ka mbështetur pjesëmarrjen e ERRU në seminare rajonale dhe konferenca ndërkombëtare të fokusuar në rregullimin e shërbimeve të ujit, monitorimin e performancës, eficiencën e shërbimeve dhe zbatimin e legjislationit evropian në sektor. Këto aktivitete kanë shërbyer si platforma për diskutim mbi sfidat rregullatore dhe për shkëmbimin e praktikave më të mira mes rregullatorëve dhe ekspertëve të rajonit.

Në kuadër të programit të Danubit për Ujin, një tjetër partner i rëndësishëm bashkë me Bankën Botërore ishte Qeveria Austriake, e cila asistoi në dy aktivitete madhore për sektorin: Konferenca Vjetore e Danubit për Ujin dhe “Rrjedhja e Njohurive për Ujin në Vjenë”. Pjesëmarrja e ERRU-së përfshiu prezantime mbi situatën e sektorit në Shqipëri, përvojën me shoqëritë e agreguara, si dhe vizita studimore në sistemet e furnizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, duke mundësuar diskutime të drejtpërdrejta mbi zgjidhjet inovative dhe qëndrueshmërinë e sektorit.

ERRU ishte pjesë edhe e aktiviteteve të mbështetura nga Unioni për Mesdheun (UFM) dhe Bashkimi Evropian, në kuadër të *konferencave ndërkombëtare mbi financimin dhe investimet në sektor*. Këto angazhime krijuan mundësi për përfshirjen e perspektivës rregullatore shqiptare në dialogun

ndërkombëtar mbi prioritetet e financimit dhe nevojën për investime në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

Gjatë vitit 2025, ERRU përfitoi gjithashtu nga mbështetja e UN-Habitat, përmes Global Water Operators' Partnerships Alliance (GWOPA), duke marrë pjesë në Kongresin Global të Operatorëve të Ujit. Ky angazhim i mundësoi institucionit të kontribuojë në diskutimet globale mbi menaxhimin e qëndrueshëm të shërbimeve ujësjellës-kanalizime, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe avancimin drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Mbështetje e rëndësishme për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të ERRU ka ardhur edhe nga programet e Partneritetit të Danubit, RCDN/RCDN+ dhe D-LeaP, të fokusuara në rregullimin ekonomik, menaxhimin financiar, aksesin në financim, planifikimin e sigurisë së ujit dhe menaxhimin e krizave. Përmes këtyre programeve, stafi i ERRU ka përfituar trajnime të specializuara dhe ushtrime praktike, duke forcuar aftësitë institucionale për mbikëqyrjen efektive të shërbimeve të ujit.

Gjatë vitit 2025, ERRU mori pjesë në Programin e Qeverisjes së Shërbimeve të organizuar nga IAWD dhe mbështetur nga RCDN, ku përfaqësues nga gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor ndanë praktikat më të mira të qeverisjes ujore, rregullimit ekonomik, tarifave dhe menaxhimit të aseteve.

Në të njëjtin vit, ERRU ishte pjesë edhe e konferencës përmbyllëse të një projekti për mbrojtjen dhe menaxhimin e integruar të lumit Vjosë, një nismë e financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Ky aktivitet theksoi nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërkufitare në administrimin e burimeve ujore, duke nxitur bashkëpunimin mes institucioneve, komuniteteve dhe aktorëve ndërkombëtarë, si dhe shërbeu si platformë për të ndarë arritjet dhe për të planifikuar hapa të mëtejshëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm të lumit dhe burimeve të tij ujore.

Bashkëpunimi me organizatat rajonale dhe kombëtare, si SHUKALB dhe SHUKOS, u konkretizua me pjesëmarrjen aktive në Konferencën dhe Ekspozitën Ballkanike mbi qëndrueshmërinë e sektorit, e cila organizohet çdo vit. Në konferencën me temë: “Menaxhimi i sektorit të ujit, ndërtimi i kapaciteteve dhe mundësitë e financimit”, ERRU prezantoi vizionin për një sektor të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt politikave me impakt afatgjatë.

– Marrëdhëniet Bilaterale

Gjatë vitit 2025, ERRU ka forcuar marrëdhëniet bilaterale me rregullatorët homologë në rajon e përtej, duke u mbështetur në bashkëpunimet e konsoliduara në vitet e mëparshme dhe duke zgjeruar bashkëpunimin me partnerë të rinj ndërkombëtarë. Veprimtaria u përqendrua në shkëmbimin e përvojave rregullatore, harmonizimin e qasjeve metodologjike dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve të ujit dhe përputhjes me standardet evropiane. Në këtë kuadër, në qershor të vitit 2025 u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi me Autoritetin Rregullator Grek për Energjinë, Mbetjet dhe Ujin (RAAEY), duke vendosur themelet e një bashkëpunimi strategjik dhe afatgjatë në fushën e rregullimit të sektorit. Marrëveshja synon krijimin e një kuadri të qëndrueshëm për shkëmbimin e njohurive, zhvillimin e projekteve të përbashkëta, rritjen e efikasitetit rregullator dhe forcimin e transparencës, në përputhje me objektivat dhe standardet e BE-së. Paralelisht, ka vijuar bashkëpunimi me Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit në Kosovë (ARRU), nëpërmjet zhvillimit të takimeve të përbashkëta, të fokusuara në çështje kyçe të sektorit si performanca dhe besueshmëria e të dhënave, procesi tarifor, menaxhimi financiar i

shoqërive UK, standardet e shërbimit, trajtimin e ankesave të konsumatorëve, si dhe ndikimin e rajonalizimit në përmirësimin e treguesve të performancës. Pjesëmarrja e rregullatorëve të tjerë nga Maqedonia (ERC) dhe Mali i Zi (REGAGEN) i dhanë këtij bashkëpunimi një dimension më të gjerë ndërinstitucional.


2.6 MENAXHIMI ADMINISTRATIV, FINANCIAR DHE ORGANIZATIV

2.6.1 Struktura Organizative e ERRU-së

Forma organizative, struktura dhe organika e ERRU rregullohen në përputhje me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për Pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të Pavarura Kushtetuese dhe të Institucioneve të tjera të Pavarura, të krijuara me ligj”.

Si institucion i pavarur i krijuar me ligj, struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës në ERRU miratohen me vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuadër, struktura aktuale është miratuar me Vendimin nr. 33/2022 të Kuvendit, “Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”.

Figura nr. 3 Struktura e ERRU



Miratimi i kësaj strukture ka mundësuar përshtatjen organizative të institucionit me zhvillimet në sektor, duke forcuar kapacitetet rregullatore, teknike dhe administrative në funksion të përmbushjes së detyrave ligjore.

Aktualisht, ERRU përbëhet nga 29 punonjës, konkretisht: 5 anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator, 1 Sekretar i Përgjithshëm, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës.

Kjo strukturë, ka për qëllim rritjen e efikasitetit, profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të rregullatorit duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat dhe sfidat që ERRU-ja ka përballë reformës së sektorit që burojnë edhe nga objektivat strategjike të institucionit.

2.6.2 Të Ardhurat


Burimet e financimit të ERRU përbëhen nga pagesat rregullore të operatorëve që operojnë në sektor, tarifatat për licencim si dhe donacionet, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar.

Në zbatim të këtij kuadri ligjor, ERRU ka lidhur kontrata dhe aktmarrëveshje me operatorët e sektorit, në të cilat janë përcaktuar niveli i pagesës rregullore vjetore si dhe afatet për likuidimin e saj.

Detyrimi vjetor për pagesat rregullore për vitin 2025, bazuar në kontratat dhe aktmarrëveshjet në fuqi me 14 shoqëritë rajonale ujësjellës-kanalizime dhe 2 shoqëri të tjera UK, arrin në shumën 90,153,741 lekë. Ndërkohë, detyrimet e mbartura nga vitet paraardhëse për pagesat rregullore rezultojnë në shumën 36,320,052 lekë.

Siç pasqyrohet në grafikun më poshtë, gjatë vitit 2025, arkëtimet totale të realizuara nga ERRU kapin vlerën 113,916,315 lekë, nga të cilat 113,396,315 lekë i përkasin pagesave rregullore, ndërsa 520,000 lekë tarifave të licencimit. Në grafik janë pasqyruar krahasimisht edhe të dhënat e viteve 2023 dhe 2024.

Grafiku nr.2 Realizimi i arkëtimeve sipas zërave



Për mbledhjen e detyrimeve të papaguara ndaj ERRU-së, gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë veprime administrative, përfshirë njoftimin zyrtar të subjekteve për përmbushjen e detyrimeve përkatëse.

Shlyerja e detyrimeve të pagesës për licencimin ndaj ERRU-së ka qenë e rregullt, duke qenë detyrim paraprak dhe kusht i domosdoshëm për licencimin dhe rinovimin e licencave të shoqërive UK.

Likuiditetet e disponueshme në përfundim të vitit 2025 garantojnë tërësisht mbështetjen financiare për ushtrimin e aktivitetit të ERRU-së për vitin 2026, duke mbuluar në mënyrë të plotë shpenzimet vjetore të parashikuara.


2.6.3 Shpenzimet Operative

Administrimi i vlerave materiale dhe monetare në ERRU kryhet në përputhje të plotë me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, si dhe me Rregulloren e Brendshme të ERRU-së “Për menaxhimin e aktiveve”.

Plani vjetor i shpenzimeve operative hartohet nga ERRU dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar. Për vitin 2025, plani vjetor i shpenzimeve operative është miratuar me VKM nr. 663, datë 23.10.2024, me fond të përgjithshëm në shumën 71,449,000 lekë.

Në vijim, KKRR, me Vendimin nr. 2, datë 13.01.2025, ka detajuar fondin e miratuar në artikuj specifikë shpenzimesh, në përputhje me nevojat për mbështetje logjistike, realizimin e objektivave vjetore dhe garantimin e funksionimit normal të institucionit.

Grafiku nr. 3 Struktura e Planit të Shpenzimeve Operative



Plani vjetor i shpenzimeve operative të vitit 2025 është strukturuar në tre kategori kryesore:

- paga;
- sigurime shoqërore dhe shëndetësore;
- shërbime dhe furniturë.

Në grafikun e mësipërm është pasqyruar struktura e planit të shpenzimeve 2025 në raport vitet 2023 dhe 2024.


Shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të ERRU-së gjatë vitit 2025, janë në shumën 66 301 791 lekë, ose 93 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative.

Realizmi i shpenzimeve në zëra dhe në vlera paraqiten si më poshtë:

- 46 193 426 lekë / 93%, shpenzime për pagat e punonjësve;
- 7 292 991 lekë / 92% shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore;
- 12 815 374 lekë / 93% shpenzime për shërbime e furniturë.

Plani i miratuar i shpenzimeve operative të ERRU krahasuar me shpenzimet e realizuara të vitit 2025 krahasimisht me të dhënat e viteve 2023 dhe 2024 paraqitet në vijim në formë grafike:

Grafiku nr. 4 Plani i Shpenzimeve të Miratuara krahasuar me Shpenzimet e Realizuara



2.6.4 Auditimet

Gjatë vitit 2025, në ERRU janë ushtruar procese inspektimi dhe auditimi nga autoritete kompetente, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 821, datë 26.12.2024 të Këshillit të Ministrave “Për Organizimin dhe Funkionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka kryer një inspektim në ERRU.

Objekti i inspektimit ka qenë evidentimi dhe administrimi i dokumentacionit arkivor, certifikimi dhe plotësimi i regjistrave, përpilimi i pasqyrës emërtuese të dosjeve, ngritja dhe funksionimi i Komisionit të Ekspertizës, përcaktimi i afateve të ruajtjes së dokumenteve, përpunimi tekniko-shkencor i tyre, si dhe verifikimi i kushteve të ruajtjes së dokumentacionit në sekretari-arkiv.

Vendimi përfundimtar i inspektimit, së bashku me rekomandimet përkatëse, i vënë në dispozicion në muajin nëntor 2025, kërkon sistemimin e dosjeve sipas pasqyrës emërtuese, zbatimin e rregullave për administrimin e dokumentacionit në rast lëvizjeje të punonjësit të Protokoll-Arkivës, si dhe nisjen e përpunimit dhe veçimit/asgjësimit të dokumenteve me afat ruajtjeje të përkohshëm.

Në mbështetje të dispozitave të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Standardeve ISSAI, dhe në zbatim të Kontratës nr. 447/1 Prot., datë 15.11.2025, ndërmjet ERRU-së dhe Audituesit të Brendshëm në sektorin publik, në institucion është kryer auditimi financiar dhe i përputhshmërisë për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024.

Auditimi është realizuar përmes kontrollit dokumentar, intervistave, analizës së riskut dhe verifikimeve fizike.

Në përfundim të auditimit u konstatua se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të saktë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të institucionit, si dhe rezultatet e veprimtarisë dhe flukset monetare, në përputhje me standardet e kontabilitetit në fuqi. Për disa sektorë të veçantë u evidentuan gjetje dhe rekomandime për përmirësim, ndërkohë që në tërësi institucioni paraqiti një nivel të kënaqshëm përputhshmërie me kuadrin ligjor.

Në vijim, bazuar në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në Standardet ISSAI dhe në bazën ligjore funksionale të veprimtarisë së ERRU-së, Kontrolli i Lartë i Shtetit, përmes Departamentit të Auditimit të Institucioneve të Sigurisë, Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, ka zhvilluar një auditim përputhshmërie me zgjedhje mbi bazë risku për periudhën 01.01.2024 – 31.10.2025.

Në përfundim të procedurës së auditimit, bazuar në të dhënat e mbledhura, akt-konstatimet dhe akt-verifikimet janë hartuar dhe dërguar observacionet përkatëse. Në vijim pritet të na vihet në dispozicion Projekt Raporti i Auditit si dhe Raporti Përfundimtar (përgjatë vitit 2026)

2.6.5 Statusi i Ankimeve Gjyqësore

Në kuadër të transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale, gjatë vitit 2025 ERRU ka qenë palë në 4 procese gjyqësore, kryesisht me objekt mosmarrëveshje të natyrës administrative dhe të marrëdhënieve të punës, si dhe një çështje që lidhet me kundërshtimin e një akti administrativ në sektor.

Dy prej çështjeve lidhen me pretendime për dëmshpërblime për zgjidhje të kontratës së punës dhe shpërblim për vjetërsi, të cilat aktualisht ndodhen në faza të ndryshme shqyrtimi në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë. Një çështje tjetër është në proces apelimi pas një vendimi të shkallës së parë me pranim të pjesshëm të kërkesëpadisë. Ndërkohë, një proces pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ndodhet në fazën fillestare të shqyrtimit.

ERRU ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore në mbrojtje të interesave institucionale, duke respektuar kuadrin ligjor dhe duke garantuar përfaqësim të rregullt në të gjitha shkallët e gjykimit.

3. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SEKTORIT UK

3.1 PRONËSIA

Sistemet e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura përbëjnë ***pasuri të paluajtshme publike në pronësi të shtetit shqiptar***, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2025, forma e organizimit të sektorit nuk pësoi ndryshime krahasuar me vitin paraardhës. *Reforma e miratuar në vitin 2022*, sipas së cilës sektori funksionon përmes 14 shoqërive rajonale ujësjellës-kanalizime, të organizuara në formën e shoqërive aksionare me sistem administrimi me dy nivele.

Struktura e pronësisë së këtyre shoqërive është e përbashkët ndërmjet qeverisë qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore. Në secilën prej shoqërive rajonale:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë zotëron **51% të aksioneve**;
- njësitë e vetëqeverisjes vendore zotërojnë **49% të aksioneve**.

Ndarja e aksioneve ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore është realizuar në përpjesëtim me numrin total të abonentëve aktivë që kanë pasur shoqëritë ekzistuese në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta (SKP). *Ky mekanizëm synon të reflektojë peshën reale të shërbimit në përbërjen e strukturës aksionare.*

Në rajonin e Tiranës, gjatë vitit 2025, shërbimi i furnizimit me ujë dhe i largimit e përpunimit të ujërave të ndotura vijoi të ofrohet nga tre shoqëri të veçanta UK (Tiranë, Vorë dhe Kamëz), të organizuara si shoqëri aksionare me një nivel administrimi, ku **bashkia përkatëse zotëron 100% të aksioneve**. *(Lista e plotë e shoqërive UK/RUK dhe përbërja e aksionarëve paraqitet në Aneksin përkatës.)*

Pavarësisht reformimit institucional të ndërmarrë ndër vite, shoqëritë ujësjellës-kanalizime vijnë të mbajnë përgjegjësi të plotë në juridiksionin e tyre për administrimin e sistemit në të gjitha fazat e tij: prodhim, përpunim, grumbullim, shpërndarje, furnizim, largim dhe trajtim të ujërave të ndotura.

Gjatë vitit 2025, qeveria qendrore prezantoi një qasje të re reformuese në sektor, e cila synon ndarjen e funksionit të prodhimit të ujit nga ai i shpërndarjes, me qëllim rritjen e eficiencës dhe specializimit operacional.

3.2 GJENDJA E SEKTORIT UK

3.2.1 Shfrytëzimi dhe kontrolli i ujësjellësve

Shfrytëzimi dhe kontrolli i sistemeve të ujësjellësit përbëjnë një komponent të rëndësishëm për garantimin e një shërbimi të sigurt, të qëndrueshëm dhe ekonomikisht të përballueshëm për konsumatorët. Gjatë vitit 2025, analiza e ERRU tregon se, megjithëse në nivel kombëtar disponohen

kapacitete të mjaftueshme të burimeve ujore, mënyra e shfrytëzimit operacional të sistemeve të furnizimit me ujë paraqet ende diferenca ndërmjet shoqërive UK dhe zonave të shërbimit, të cilat kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Në një pjesë të shoqërive UK, shfrytëzimi i sistemeve të furnizimit me ujë vijon të zhvillohet mbi bazën e praktikave ekzistuese operative, ndërkohë që po ndërmerren hapa gradualë drejt forcimit të planeve të menaxhimit të aseteve dhe mirëmbajtjes parandaluese. Procesi i modernizimit të operimit të veprave të marrjes, depove dhe stacioneve të pompimit pritet të kontribuojë në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë dhe vazhdimësisë së shërbimit, si dhe në optimizimin e kostove operative.

Në drejtim të kontrollit teknik dhe operacional, po evidentohet një orientim gjithnjë e më i qartë drejt përdorimit të sistemeve të monitorimit dhe matjes, me synim rritjen e transparencës dhe forcimin e vendimmarrjes së bazuar në të dhëna. Zgjerimi gradual i këtyre praktikave pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen e eficiencës së administrimit të rrjeteve dhe në qëndrueshmërinë e shërbimit në afatmesëm.

Nga analiza për vitin 2025 rezulton se, ndërmjet shoqërive UK, evidentohen nivele të ndryshme të kapaciteteve njerëzore, menaxheriale dhe teknike, si dhe shkallë të ndryshme të zbatimit të standardeve dhe procedurave të mirëmbajtjes. Kjo situatë pasqyron fazën e tranzicionit në të cilën ndodhet sektori dhe njëkohësisht krijon hapësirë për harmonizim dhe forcim të mëtejshëm të praktikave të brendshme të kontrollit teknik dhe operacional, të cilat përbëjnë një prioritet në vijim.

Në kuadër të reformës dhe procesit të rajonalizimit, shoqëritë UK po orientohen gradualisht drejt një qasjeje më proaktive, të mbështetur në menaxhimin e aseteve, planifikimin afatmesëm të ndërhyrjeve dhe optimizimin e operimit të sistemeve ekzistuese. Përmirësimi i kontrollit operacional, digjitalizimi i proceseve dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafeve teknike përbëjnë elementë kyç që pritet të kontribuojnë në rritjen e eficiencës së shfrytëzimit të sistemeve të furnizimit me ujë.

ERRU, në ushtrimin e funksioneve të saj rregullatore, vijon të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme mënyrën e shfrytëzimit dhe kontrollit të shoqërive UK përmes analizës së treguesve të performancës, shqyrtimit të planeve të biznesit, programeve të investimeve dhe procedurave operative. Rezultatet e këtij monitorimi shërbejnë për orientimin e rekomandimeve rregullatore dhe për mbështetjen e shoqërive në drejtim të përmirësimit të standardeve të punës dhe konsolidimit të një menaxhimi më eficient dhe të qëndrueshëm të infrastrukturës.

Në këtë kontekst, forcimi i një shfrytëzimi të kontrolluar dhe të standardizuar të sistemeve të furnizimit me ujë vlerësohet si një element thelbësor për rritjen graduale të cilësisë së shërbimit dhe përmbushjen e objektivave afatgjata të sektorit.

3.2.2 Kapaciteti i trajtimit dhe shpërndarjes së ujit si dhe parashikimi i kërkesës për ujë në të ardhmen

Bazuar në analizën e ERRU për vitin raportues 2025, konstatohet se kapacitetet ekzistuese të prodhimit, trajtimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm paraqesin nivele të ndryshme zhvillimi ndërmjet shoqërive UK dhe territoreve të shërbimit, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor. Kjo situatë pasqyron historikun e investimeve dhe dinamikat e ndryshme demografike dhe ekonomike të zonave të shërbimit, duke krijuar njëkohësisht hapësirë për harmonizim dhe optimizim të mëtejshëm të kapaciteteve.

Në një pjesë të sistemeve të furnizimit me ujë, kapacitetet e instaluara janë projektuar mbi baza demografike dhe modele konsumi historike. Zhvillimet urbane, ekonomike dhe sezonale të viteve të

fundit theksojnë nevojën për përditësimin gradual të këtyre projeksioneve, në mënyrë që planifikimi i ardhshëm të reflektojë më mirë realitetin aktual dhe perspektivën e zhvillimit.

Në nivel sektorial, evidentohet ende një diferencë ndërmjet kapacitetit teorik të prodhimit të ujit dhe sasisë reale të ujit të faturuar. Kjo diferencë lidhet kryesisht me nivelin e humbjeve në rrjet dhe me nevojën për përmirësim të mëtejshëm të administrimit teknik të sistemeve të shpërndarjes. Megjithatë, disponueshmëria e burimeve ujore në shumë zona ofron bazë të qëndrueshme për përballimin e kërkesës aktuale dhe potenciale, nëse shoqërohet me investime dhe masa për rritjen e eficiencës së rrjeteve ekzistuese.

Në drejtim të trajtimit të ujit të pijshëm, kapacitetet ekzistuese përbëjnë një element kyç për garantimin e cilësisë së shërbimit. Në disa sisteme ku furnizimi realizohet nga burime të pa pajisura me Impiant Trajtimi të Ujit të Pijshëm (ITUP), vlerësohet e nevojshme vijimi i investimeve për forcimin e sigurisë dhe përmbushjen e plotë të standardeve të cilësisë, veçanërisht në kushtet e presioneve mjedisore dhe ndryshimeve klimatike.

Sa i takon kapacitetit të shpërndarjes, në zona urbane dhe turistike me zhvillim të shpejtë ekonomik, kërkesa sezonale për ujë paraqet sfida shtesë për administrimin e presioneve dhe garantimin e furnizimit të qëndrueshëm. Kjo situatë evidenton rëndësinë e planifikimit të integruar të investimeve dhe të përmirësimit të menaxhimit të rrjeteve për të përballuar pikat e pikut të konsumit.

Nga perspektiva e parashikimit të kërkesës për ujë, ERRU vlerëson se planifikimi afatmesëm dhe afatgjatë i sektorit duhet të mbështetet në analiza më të avancuara, të cilat të integrojnë faktorë demografikë, zhvillimin e turizmit, ndryshimet klimatike dhe objektivat për rritjen e nivelit të shërbimit. Përmirësimi gradual i vazhdimësisë së furnizimit dhe formalizimi i konsumit pritet të ndikojnë në rritjen e kërkesës reale për ujë të faturuar në vitet në vijim.

Në këtë kuadër, rritja e kapaciteteve efektive të shpërndarjes duhet të ecë paralelisht me reduktimin e humbjeve dhe përmirësimin e menaxhimit të aseteve ekzistuese. Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemeve aktuale përbëjnë një alternativë me efekt të drejtpërdrejtë në rritjen e eficiencës, duke reduktuar nevojën për investime të menjëhershme në burime të reja uji.

Në përfundim, vlerësimi i kapaciteteve të trajtimit dhe shpërndarjes, si dhe parashikimi realist i kërkesës për ujë, përbëjnë elementë themelorë për orientimin e planifikimit të investimeve pas vitit 2025. ERRU do të vijojë të inkurajojë shoqëritë UK që planet e tyre të zhvillimit të mbështeten në analiza të qëndrueshme teknike dhe financiare, me synim garantimin e një shërbimi cilësor, të qëndrueshëm dhe të përballueshëm për konsumatorët.

3.2.3 Licencat dhe Tarifat

– Licencat

Në sektor, shërbimi i grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik ofrohet nga 14 shoqëri rajonale, subjekte me kompetenca të përbashkëta, të licencuara nga ERRU, si dhe nga 3 shoqëri ekzistuese UK, konkretisht UK Tiranë, UK Vorë dhe UK Kamëz, të cilat ende nuk janë riorganizuar në përputhje me VKM nr. 302, datë 11.05.2022. (Aneksi 1)

Shërbimi i përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik realizohet nga 2 shoqëri, përkatësisht UK Tiranë, nëpërmjet impiantit të trajtimit të ujit të pijshëm të Bovillës, dhe Shoqëria Rajonale UK Durrës, përmes impiantit të trajtimit të ujit të pijshëm të Manskurisë (Kavajë). Shërbimi i grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura ofrohet nga të gjitha shoqëritë UK, ndërsa përpunimi i ujërave të ndotura realizohet vetëm përmes 8 impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN), të ndërtuara dhe funksionale, pjesë e Shoqërive Rajonale UK Durrës (ITUN Durrës, Kavajë dhe Gjiri i Lalzit), SHRUK Shkodër (ITUN Velipojë dhe Shirokë), SHRUK Lezhë, SHRUK Korçë dhe SHRUK Pogradec. Këto impiante janë të pajisura me licencë përkatëse nga ERRU. (Shihni Aneksin 1)

Tabela nr. 10 Kategoritë e licencimit

Kategoritë	Nr. i shoqërive të licencuara
A- Grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik	17
B-Përpunimi i ujit për konsum publik	2
C - Largimin i ujërave të ndotura	17
D - Përpunimi i ujërave të ndotura	5

Ndërkohë, 2 impiante të tjera ende nuk përmbushin kërkesat ligjore për pajisje me licencë për këtë kategori shërbimi, përkatësisht ITUN Sarandë, në administrim të SHRUK Sarandë, si dhe ITUN Vlorë dhe Orikum, në administrim të SHRUK Vlorë nuk kanë arritur ende të plotësojnë kërkesat për tu pajisur me Leje Mjedisore për këto ITUN që administrojnë.


Gjatë vitit 2025, sektori i ujësjellës-kanalizimeve ka funksionuar në kuadër të plotë rregullator, pasi të gjitha shoqëritë UK kanë qenë të pajisura me licencë të vlefshme nga ERRU, çka ka mundësuar monitorimin e performancës së tyre teknike dhe financiare.

– Tarifat

Në fund të vitit 2025, kemi 14 shoqëri rajonale nga të cilat, 5 prej tyre pa tarifa të miratuara nga ERRU dhe një shoqëri UK pa tarifa të miratuara nga ERRU. Këto shoqëri, në zbatim edhe te vendimit të KRRR, vijojnë të përdorin tarifatat që kanë në fuqi, të miratuara nga Këshillat Bashkiak përkatës.

Viti 2025 konsiderohet viti i tretë i implementimit të reformës në sektorin UK, në zbatim të VKM-së nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të FU dhe KUN” ku deri në fund të vitit 2025 janë krijuar 14 shoqëri Rajonale UK nga 15 të parashikuara.

Grafiku nr. 5 Formalizimi me tarifa



Vijon të mbetet problematike fakti që 5 shoqëri rajonale nuk kanë ende tarifë të miratuar nga ERRU, si shoqëri rajonale. Këto shoqëri janë SHRUK Dibër, Lushnje, Sarandë, Vlorë, Kukës si dhe SHUK Kamëz. Këto shoqëri vijnë të përdorin tarifën ekzistuese sipas vendimit të KKRR nr. 420, datë 29.09.2022 “Për licencat dhe tarifën e shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjektet me kompetencë të përbashkëta”, i ndryshuar. Njësi të caktuara brenda këtyre shoqërive rajonale, nuk kanë tarifë të miratuar nga ERRU por nga Këshillat Bashkiakë përkatës, konkretisht, njësi Klos në SHRUK Dibër; njësi Divjakë në SHRUK Lushnje; njësi Finiq në SHRUK Sarandë dhe njësi Has në SHRUK Kukës. Ndërkohë SHUK Kamëz vijon me tarifën e Këshillat Bashkiakë.

Pavarësisht komunikimeve të vazhdueshme, takimeve pranë çdo shoqërie, ende asnjë nga këto shoqëri nuk ka aplikuar.

3.2.4 Investimet në Sektorin UK

Portofoli i projekteve të raportuara përfshin rreth 290 investime infrastrukturore, me një vlerë totale kontratash prej rreth 39.3 miliardë lekësh dhe realizim financiar kumulativ prej afro 25.5 miliardë lekësh për periudhën 2019–2025. Investimet janë përqendruar kryesisht në ndërtimin dhe rehabilitimin e sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe në kontrata mbikëqyrjeje, me qëllim garantimin e cilësisë dhe standardeve teknike të zbatimit.

Analiza e këtyre projekteve tregon se 206 prej tyre, ose rreth 71% e totalit, lidhen drejtpërdrejt me furnizimin me ujë të pijshëm. Në aspekt financiar, kjo prirje paraqitet edhe më e theksuar, pasi projektet ujësjellëse përfaqësojnë mbi 66% të vlerës totale të kontratave. Ky orientim reflekton prioritetin e dhënë përmirësimit të aksesit në ujë të pijshëm dhe modernizimit të infrastrukturës bazë, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve fizike të shërbimit dhe përmirësimin gradual të sigurisë së furnizimit.

Investimet në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, të realizuara nëpërmjet agjencisë zbatuese AKUK, ndahen në kategoritë e mëposhtme:

I. Të financuara nga buxheti i shtetit, përkatësisht:

- investime fizike në sistemet e FU dhe KUN;
- investime për studim-projektim-mbikëqyrje punimesh të investimeve fizike;

- kontributet lokale në zbatim të projekteve të financuara;
- kosto Lokale.

II. Investime të projekteve të financuara nga donatorët e huaj sipas marrëveshjeve përkatëse me qeverinë shqiptare.

Referuar të dhënave të raportuara nga AKUK për vitin 2025, investimet sipas kategorive të mësipërme paraqiten në tabelën nr. 11. Nga analiza e tyre rezulton se për vitin 2025 janë planifikuar fonde në vlerën prej 14,463,669,000 lekë (rreth 146.6 milionë euro), ndërsa janë disbursuar 14,762,514,745 lekë (rreth 147.6 milionë euro), duke arritur një nivel realizimi prej 102% të planit vjetor.

Nga totali i investimeve të disbursuara në vlerën 14,762,514,745 lekë, 11,658,636,761 lekë (rreth 79%) janë financiar nga Qeveria Shqiptare, ndërsa 3,104,150,984 lekë (rreth 21%) janë financiar nga donatorët e huaj.

Struktura e financimit tregon se pjesa më e madhe e burimeve gjatë vitit 2025 është orientuar drejt objekteve në vazhdim, me një vlerë prej rreth 10.56 miliardë lekë. Financimi për objekte të reja me burime të brendshme nga buxheti i shtetit ka qenë i kufizuar, në nivelin 21.7 milionë lekë.

Megjithëse niveli i realizimit financiar paraqitet i kënaqshëm, analiza strukturore evidenton një balancë të kufizuar ndërmjet komponentit të furnizimit me ujë dhe atij të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe një fragmentim territorial të ndërhyrjeve. Në disa raste, projektet zhvillohen pa një lidhje të plotë me kapacitetet operative dhe financiare të shoqërive rajonale UK, duke rritur rrezikun që përmirësimet infrastrukturore të mos shoqërohen me qëndrueshmëri afatgjatë të shërbimit.

Investimet fizike mbeten të orientuara drejt mbështetjes së reformës së sektorit UK dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare, në funksion të përmbushjes së nevojave të një ekonomie në zhvillim.

Në tabelën nr. 11 paraqiten në mënyrë të detajuar zërat buxhetorë të planifikuar dhe të disbursuar për vitin 2025, të ndarë sipas objekteve në proces dhe objekteve të reja.

Pavarësisht volumit të konsiderueshëm të investimeve të realizuara, përmirësimi i treguesve të performancës financiare të shoqërive UK vijon të paraqitet i pabarabartë. Kjo tregon se ndërhyrjet infrastrukturore, në mungesë të reformave paralele në fushën e menaxhimit, rritjes së efikasitetit operative dhe përmirësimit të strukturës tarifore, nuk janë të mjaftueshme për të garantuar vetëqëndrueshmëri financiare të sektorit.

Në këtë kontekst, procesi i miratimit të tarifave mbetet një instrument rregullator thelbësor për mbulimin e kostove reale të shërbimit, rikuperimin gradual të investimeve dhe krijimin e stimuljeve për reduktimin e humbjeve dhe rritjen e efikasitetit.

Tabela nr.11 Financimi i projekteve në vazhdim dhe të reja nga AKUK dhe burimet e huaja Viti 2025

Përshkrimi	Vlera e Planifikuar (në lekë)	Vlera e Financuar (në lekë)	Realizimi (në %)
Investimet nga AKUM	11,825,665,000	11,658,363,761	99
I. Objektet në vazhdim me financim të brendshëm	10,720,230,325	10,566,582,601	99
a) Objektet e reja të vitit 2025 me financim të brendshëm	22,073,656	21,712,578	98
b) Supervizim punimesh	127,821,426	115,170,520	90
c) Studim projektimi	316,104,611	316,104,426	
TVSH	509,846,207	509,204,861	
d) Kosto Lokale	129,588,775	129,588,775	
II. Investimet e Huaja (Objekte në vazhdim)	2,638,004,000	3,104,150,984	118
TOTALI	14,463,669,000 (eq. 146.6 mln euro*)	14,762,514,745 (eq. 147.6 mln euro*)	102

Burimi: AKUK

*1 euro=100 lekë

Në përfundim, ERRU vlerëson se investimet e realizuara përbëjnë një bazë të rëndësishme për modernizimin e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, por thekson nevojën për një qasje më të integruar në planifikimin e projekteve, lidhjen e tyre me plane biznesi të qëndrueshme dhe objektiva të matshëm të performancës, si dhe orientimin gradual të burimeve financiare drejt kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Vetëm nëpërmjet një koordinimi të qëndrueshëm ndërmjet investimeve infrastrukturore, përmirësimit të menaxhimit operacional dhe zbatimit të politikave tarifore të balancuara mund të sigurohet përmirësim afatgjatë i cilësisë së shërbimit dhe mbrojtje efektive e interesit të konsumatorit.

Informacion i detajuar mbi emërtimin e objekteve dhe vlerat përkatëse të investimeve të realizuara në sektorin UK për vitin 2025 do të paraqitet në Raportin e Veçantë të Performancës së Sektorit UK, i cili publikohet në fund të muajit qershor 2026 dhe paraqitet në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave, pas marrjes së të dhënave të certifikuara nga të gjitha shoqëritë UK.

3.2.5 Subvencionet për vitin 2025

Për vitin 2025, Qeveria Qendrore ka shpërndarë subvencione në vlerën totale prej 350 milionë lekësh për dymbëdhjetë Shoqëri Rajonale UK, nga katërbëdhjetë të krijuara deri më tani, si dhe për shoqërinë UK Vorë.

Shpërndarja e subvencioneve është realizuar në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1, datë 04.07.2025, "Për miratimin e metodologjisë, kritereve dhe procedurave për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve për vitin buxhetor 2025".

Në bazë të pikës 6(a) të këtij udhëzimi, fondi i subvencionit përdoret për të akorduar çdo muaj zbritje 100% në tarifën e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për kategoritë në nevojë, të përcaktuara në

pikën 3 të metodologjisë, për kompensimin e konsumit të sasisë minimale jetike deri në 5 m³/muaj. Për vitin 2025, vlera e përdorur për këtë qëllim, e zbatuar nga 12 Shoqëritë Rajonale UK dhe UK Vorë, është 39 milionë lekë.

Në bazë të pikës 6(b) të të njëjtit udhëzim, pjesa e mbetur e fondit të subvencionit përdoret për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për shoqëritë që kanë mbi 75% të prodhimit të ujit me ngritje mekanike. Ky kriter është zbatuar për subvencionimin e shoqërive Rajonale UK Fier, Shkodër, Elbasan, Sarandë, Durrës dhe UK Vorë.

Referuar shpërndarjes së përgjithshme për vitin 2025, rezulton se 88.8% e fondit të subvencioneve është përdorur për mbulimin e kostove të energjisë elektrike, ndërsa 11.2% është përdorur për mbështetjen e shtresave në nevojë.

Shpërndarja e subvencioneve në detaje, për vitin 2024 dhe 2025 sipas zërave përkatës, paraqitet në tabelën më poshtë.

Tabela nr.12 Shpërndarja e subvencioneve për vitin 2025 krahasuar me vitin 2024

Shpërndarja e Subvencioneve	Viti 2024 Shpërndarja		Viti 2025 Shpërndarja	
	(në Lekë)	(në %)	(në Lekë)	(në %)
Energji Elektrike	319,028,019	91.2	310,787,15	88.8
Shtresat në Nevojë	30,865,624	8.8	39,212,985	11.2
Totali	349,893,643	100	350,000,000	100

Për shoqëritë që nuk kanë përfunduar procesin e rajonalizimit, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 302, konkretisht UK Tiranë dhe UK Kamëz, të cilat pritet të konsolidohen në strukturën SKP UK Tiranë, nuk janë shpërndarë subvencione për mbulimin e kostove të energjisë elektrike apo për mbështetjen e shtresave në nevojë gjatë vitit 2025.

Kjo situatë lidhet me orientimin strategjik të qeverisë qendrore për të prioritarizuar mbështetjen financiare ndaj shoqërive UK që janë bërë pjesë e reformës së rajonalizimit, në përputhje me VKM nr. 302, ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/AKUK zotëron 51% të aksioneve.

Gjithashtu, rezulton se gjatë vitit 2025 dy shoqëri rajonale UK, përkatësisht UK Gjirokastrë dhe UK Dibër, nuk kanë përfituar subvencione.

3.2.6 Treguesit Kryesor të Performancës 2025

Monitorimi i performancës së shoqërive ujësjellës–kanalizime vijon të mbetet një nga prioritetet kryesore të ERRU-së, në funksion të forcimit të qëndrueshmërisë financiare të sektorit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Gjatë vitit 2025, ERRU ka ndjekur një qasje

komunikimi proaktive me shoqëritë UK, të shoqëruar me takime periodike dhe vizita monitoruese në terren, me qëllim identifikimin e problematikave kryesore në procesin e mbledhjes, konsolidimit dhe raportimit të të dhënave si shoqëri rajonale, si dhe orientimin e tyre drejt përmirësimit të performancës financiare dhe operacionale.

Pjesë përbërëse e këtij Raporti është edhe një pasqyrë e përgjithshme e gjendjes së sektorit për vitin 2025, e bazuar në Treguesit Kryesorë të Performancës dhe e shoqëruar me rekomandime përkatëse për përmirësimin e mëtejshëm të sektorit.

Duhet theksuar se ERRU publikon çdo vit, gjatë muajit korrik, Raportin e Monitorimit të Performancës së Sektorit për vitin paraardhës, pas përfundimit të procesit të mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave nga shoqëritë ujësjellës–kanalizime, i cili zakonisht zhvillohet pas muajit prill, në vijim të miratimit të pasqyrave financiare vjetore. Në këtë kuadër, vlerësimi i treguesve i paraqitur në këtë raport mbështetet në të dhëna paraprake dhe ka karakter orientues, duke synuar kryesisht ofrimin e një panorame të përgjithshme të zhvillimeve në sektor.

Bazuar në raportimet paraprake, krahasimi i Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2025 me vitin 2024 tregon një prirje përgjithësisht pozitive të zhvillimeve në sektor, megjithëse mbeten ende disa problematika që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme.

Në drejtim financiar, vërehet përmirësim i mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, si dhe rritje graduale e mbulimit të kostos totale, duke treguar për një forcim të qëndrueshmërisë financiare të shoqërive. Këto zhvillime pasqyrojnë ndikimin e reformës në sektor, përmirësimin e planifikimit financiar dhe përpjekjet për rritjen e disiplinës në menaxhimin e burimeve. Megjithatë, normat e arkëtimit, veçanërisht arkëtimi korrente, paraqesin ende dobësi dhe mbeten një nga sfidat kryesore për garantimin e stabilitetit financiar të shoqërive.

Nga ana teknike dhe organizative, janë evidentuar përmirësime në disa tregues të rëndësishëm të performancës. Niveli i matjes paraqitet në rritje, duke treguar për zgjerimin e pajisjes me matës dhe përmirësimin e kontrollit mbi konsumin e ujit. Eficenca e stafit është gjithashtu e përmirësuar, çka tregon përdorim më racional të burimeve njerëzore dhe organizim më të mirë të strukturave të shoqërive.

Pozitiv paraqitet edhe mbulimi i furnizimit me ujë dhe mbulimi me kanalizime, duke reflektuar zgjerimin gradual të shërbimit për popullsinë dhe përmirësimin e aksesit në infrastrukturën bazë. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë paraqitet përgjithësisht e qëndrueshme krahasuar me vitin paraardhës, duke ruajtur nivelin e ofrimit të shërbimit për konsumatorët.

Gjithashtu, është shënuar përmirësim në efencën e energjisë, si rezultat i ndërhyrjeve teknike dhe masave për uljen e konsumit të energjisë në procesin e furnizimit me ujë, duke kontribuar në uljen e kostove operative dhe në rritjen e qëndrueshmërisë së shoqërive.

Nga ana tjetër, megjithëse uji pa të ardhura paraqet një prirje përmirësimi, ai vijon të mbetet në nivele të larta, duke kërkuar intensifikim të masave për reduktimin e humbjeve fizike dhe administrative. Po ashtu, është vërejtur një rritje e lehtë e ankesave të klientëve, çka nënvizon nevojën për forcimin e komunikimit me konsumatorët dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së shërbimit.

Në tërësi, shumica e treguesve të analizuar paraqiten me prirje përmirësuese, ndërsa një pjesë e kufizuar treguesish shfaqin përkeqësim ose mbeten të pandryshuar. Kjo situatë tregon se reforma në sektorin ujësjellës–kanalizime ka filluar të japë rezultatet e para konkrete, por njëkohësisht evidenton nevojën për vijimin e përpjekjeve për rritjen e arkëtimeve, reduktimin e humbjeve, forcimin e kapaciteteve menaxheriale dhe orientimin më të fortë drejt konsumatorit, si elementë thelbësorë për ndërtimin e një sektori financiarisht të qëndrueshëm dhe me shërbim cilësor për qytetarët.

4. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE

4.1 Progresraporti i BE-së për Shqipërinë

Viti 2025 për Shqipërinë shënoi një fazë të rëndësishme dhe dinamike në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Gjatë këtij viti, vendi arriti të zhvillojë një seri konferencash të rëndësishme ndërqeveritare me BE-në dhe të hapë të gjithë grup kapitujt e negociatave të anëtarësimit, duke reflektuar një progres të qëndrueshëm për zbatimin e “acquis” së BE-së në legjislacionin kombëtar, në funksion të zbatimit të reformave të kërkuara nga procesi i negociatave.

Në kuadër të Kapitullit 28 – Mbrojtja e Konsumatorit, gjatë vitit 2025 është evidentuar nga raportet periodike me një nivel përafrimi të moderuar, me përparim të qëndrueshëm në harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator. ERRU si pjesë raportuese e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për nën kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit” ka kontribuar për këtë kapitull në përgatitjet paraprake të Planit Kombëtar të Përafrimit me Acquis të BE-së 2026–2027 si një nga instrumentet kryesore planifikuese për masat ligjore dhe politikëbërëse që lidhen me përmbushjen e kushteve të fazës aktuale të negociatave me Bashkimin Evropian.

ERRU nuk përfshihet drejtpërdrejt në udhëheqjen e procesit apo në raportimet për Kapitullin 27 “Mjedisi”, në lidhje me përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivat evropiane në fushën e Ujit të Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe të Llumrave të ITUN. Megjithatë, fokusi i ERRU, si një aktor kryesor në sektor, ka qenë përfshirja në proceset e punës për hartimin e akteve nënligjore dhe Planeve të Zbatimit të Direktivës Specifike (DSIP) për transpozimin e kërkesave të Direktivës Nr. 91/271 “Lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura urbane” dhe Direktivës Nr. 2184/2020 “Mbi cilësinë e ujit të destinuar për konsum nga njerëzit”.

4.2 Rezoluta e Kuvendit

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit, e miratuar më datë 09.10.2025, ERRU ka marrë masat për ndjekjen e rekomandimeve të lëna edhe pse afatet kohore për zbatim kanë qenë të kufizuara.

Gjithashtu, duam të theksojmë se, një pjesë e rekomandimeve të Rezolutës lidhen me **masa dhe ndërhyrje që nuk janë në kompetencën direkte të ERRU**, në cilësinë e autoritetit rregullator, por kërkojnë angazhim dhe veprim konkret nga institucionet e linjës, AKUK dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe sigurimin e burimeve financiare përkatëse.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, ERRU ka ndërmarrë veprime në kuadër të kompetencave të saj ligjore, përfshirë forcimin e komunikimit dhe takimeve teknike me shoqëritë UK, bashkëpunimin institucional me AKUK, si dhe integrimin e rekomandimeve në proceset rregullatore, teknike dhe në monitorimin e treguesve të performancës.

ERRU vlerëson se zbatimi i plotë i Rezolutës kërkon një qasje të koordinuar ndërinstitucionale dhe një angazhim të vazhdueshëm afatmesëm dhe afatgjatë të të gjithë aktorëve të sektorit, me qëllim përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare, efikasitetit operative dhe cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.

– Zbatimi i rekomandimeve 2025

1. *Të luajë rol kryesor dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët që operojnë në sektorin e ujit për të bërë të mundur realizimin e objektivave strategjik sektorial, si dhe për krijimin e një mjedisi që siguron stabilitet për shoqëritë UK dhe shërbim më të mirë për konsumatorët.*

ERRU vendos në qendër të veprimtarisë së saj forcimin e bashkëpunimit institucional me institucionet kryesore që operojnë në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, duke e konsideruar këtë bashkëpunim si një element thelbësor për realizimin dhe funksionimin efikas të kuadrit rregullator si dhe për realizimin e objektivave strategjikë të sektorit. Përmes kësaj qasjeje të integruar dhe ndërinstitucionale, ERRU synon përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe garantimin e një shërbimi të qëndrueshëm dhe cilësor për konsumatorët. Në këtë kuadër, përgjatë vitit 2025, ERRU ka vijuar bashkëpunimin institucional dhe teknik me Agjencinë Kombëtare Ujësjellës Kanalizime (AKUK) me miratimin e modelit dhe udhëzuesit të planeve të Biznesit për shoqëritë ujësjellës kanalizime i cili përbën një instrument kyç për rritjen e qëndrueshmërisë financiare, nxitjen e efikasitetit së shoqërive me objektiva financiar të mirëpërcaktuar dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit. Gjithashtu ERRU, po në bashkëpunim me AKUK ka intensifikuar punën për përfundimin e procesit të krijimit të një sistemi të unifikuar kombëtar të raportimit të të dhënave, sistem i cili do të sjell rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave.

2. *Të nxisë dhe promovojë më tej, në bashkëpunim me AKUK-në, vendosjen e sistemeve të monitorimit me kamera dhe atyre me mbrojtje perimetrale inteligjente të cilët realizojnë një mbrojtje më efikase të sigurisë së objekteve të rëndësishme të veçantë të sistemeve të FU dhe KUN dhe ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e kostove të stafit dhe përmirësimin e treguesve të performancës. Iniciativa e dy shoqërive rajonale Fier dhe Durrës në implementimin e sistemeve të monitorimit me kamera duhet të promovohet edhe për shoqëritë e tjera.*

ERRU vlerëson rëndësinë e përdorimit të teknologjive moderne për rritjen e sigurisë së objekteve që janë pjesë e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, si dhe për përmirësimin e efikasitetit operacionale të shoqërive rajonale UK.

Edhe pse kjo çështje nuk është trajtuar në mënyrë specifike në Raportin e Performancës 2024, ERRU do të marrë në konsideratë promovimin e sistemeve të monitorimit me kamera dhe mbrojtjes perimetrale inteligjente, në bashkëpunim me AKUK-në, duke evidentuar dhe shpërndarë praktikën e mira të zbatuara nga disa shoqëri rajonale. Ky drejtim do të reflektohet në rekomandimet dhe proceset rregullatore në vijim, në funksion të uljes së kostove, përmirësimit të treguesve të performancës dhe rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.

Megjithatë zbatimi konkret i këtyre masave realizohet nga vetë shoqëritë UK, përshpejtimi i përshtatjes së teknologjive të monitorimit dhe sigurisë kërkon gjithashtu mbështetje institucionale

dhe financiare nga institucionet e linjës, ministria dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, si aksionerë të shoqërive. Në këtë kuadër, ERRU do të vijojë të rekomandojë zbatimin e praktikave më të mira dhe më eficiente, ndërsa një qasje e koordinuar ndërmjet aktorëve të sektorit do të mundësonte shtrirje më të gjerë të këtyre sistemeve dhe përmirësim të sigurisë së shërbimit.

3. *Të bashkëpunojë ngushtë me AKUK për të bërë të mundur që, brenda vitit 2025, Sistemi i Integruar i Informacionit të Performancës (IPIS) të jetë funksional dhe në përdorim, saktësia dhe unifikimi i të dhënave të raportuara nga shoqëritë UK është shumë i rëndësishëm dhe shërben si një bazë e fortë për planifikimin e politikave të zhvillimit të këtij sektori në funksion të qytetarëve.*

ERRU ka evidentuar të dhënat e nevojshme që trajtohen dhe analizohen në funksion të vlerësimeve periodike apo krijimit të raporteve të performancës, duke identifikuar edhe periodicitetin e nevojshëm për gjenerimin e të dhënave dhe në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me AKUK, mbi raportimin e të dhënave të shoqërive UK pranë sistemit të Integruar të Informacionit të Performancës, këto të dhëna i janë vënë në dispozicion AKUK-ut, për t'u përfshirë në sistem.

Gjatë vitit 2025, janë zhvilluar takime të vazhdueshme ndërmjet përfaqësuesve të ERRU-së dhe AKUK, në lidhje me këtë sistem dhe aktualisht, janë duke u krahasuar të dhënat (bashkë me periodicitetin) që trajton AKUK, me të dhënat që i nevojiten ERRU-së, për të konkluduar në një bazë të dhënash të unifikuar.

4. *Pas aplikimit të 6 shoqërive Rajonale për nivel të ri tarifor, të vijojë të asistojë shoqëritë e tjera rajonale, në lidhje me problematikat që në mjaft raste priten të hasen nga propozimet e tarifave të reja, duke zbatuar metodologjinë e re të tarifave të shërbimeve UK.*

Në këtë kuadër, ERRU ka realizuar takime të vazhdueshme dhe sipas tematikave, me shoqëritë UK, ndër të tjera edhe për të dhënë mbështetjen në rastet e aplikimit për nivel të ri tarifor apo pajisje me tarifa nga ERRU.

KKRR, me vendimin nr. 33, datë 14.11.2025 "Për miratimin e modelit dhe udhëzuesit të planit të biznesit 5 vjeçar për SHRUK-të", ka miratuar modelin dhe udhëzuesin e planit të biznesit, të hartuar në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe të konsultuar me të gjitha shoqëritë e ujësjellës kanalizime, AKUK dhe palët e interesit. Dokumenti, i cili do të duhet të aplikohet nga të gjitha shoqëritë, si një instrument ndihmës dhe unifikues, është hartuar konform kërkesave të aplikimit të përcaktuar në metodologjinë dhe procedurën për miratimin e tarifave.

Ajo çfarë vërehet është rritja graduale e ndërgjegjësimit të shoqërive për rëndësinë e zbatimit të periudhës rregullatore dhe të ndikimit të saj në performancën financiare dhe operative në përfundim të kësaj periudhe. Një nga arritjet e ERRU është konsolidimi i funksionimit të shoqërive në kuadër të periudhave rregullatore, ku përcaktohen jo vetëm nivelet tarifore, por edhe objektivat e performancës që duhet të arrihen, duke siguruar operim më formal, transparent dhe nën monitorim të vazhdueshëm rregullator.

Megjithatë, përveç rolit rregullator dhe asistues të ERRU-së, është e nevojshme që çështjet rregullatore dhe të qëndrueshmërisë financiare të shoqërive të jenë në vëmendje të vazhdueshme

edhe të institucioneve përgjegjëse të linjës, AKUK dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e aksionerëve të shoqërive.

Një angazhim më proaktiv i këtyre aktorëve, përmes mbështetjes në zbatimin e planeve të biznesit, ndjekjes së objektivave të performancës dhe ndërmarrjes në kohë të masave korrigjuese, do të kontribuonte ndjeshëm në përmirësimin e gatishmërisë së shoqërive për aplikime tarifore të qëndrueshme dhe në forcimin e përgjegjshmërisë institucionale në sektor.

5. Krijimi dhe organizimi i shoqërive rajonale ujësjellës kanalizime paraqet sfida të reja në drejtim të organizimit për trajtimin e ankesave të konsumatorëve, ndaj ERRU-ja duhet të intensifikojë punën e monitorimit në terren të ankesave të konsumatorëve, veçanërisht të ankesave me natyrë teknike, që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e furnizimit me ujë të pijshëm.

Një nga mekanizmat kryesorë të ERRU-së për mbrojtjen e konsumatorëve edhe pse në nivel rekomandues, është sigurimi që përmes procesit të trajtimit të ankesave, konsumatorët të trajtohen në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe transparente në zgjidhjen e problematikave të ngritura. Paralelisht, ky mekanizëm shërben si instrument për identifikimin dhe evidentimin e problematikave të shoqërive ujësjellës-kanalizime në drejtim të ofrimit të shërbimit UK.

Në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të konsumatorëve dhe shoqërive UK mbi rolin ndërmjetësues të ERRU-së në trajtimin e ankesave dhe mbrojtjes së konsumatorit, rregullatori ka forcuar funksionimin e strukturës së zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM). Megjithatë kapacitetet profesionale dhe burimet njerëzore të ERRU-së për funksionimin e kësaj strukture janë të kufizuara, ERRU ka siguruar vijimësinë dhe efektivitetin e këtij mekanizmi përmes prioritizimit të ankesave kryesisht me natyrë teknike dhe me impakt të drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit, duke ndërthurur verifikimet në terren me zhvillimin e takimeve të drejtpërdrejta ndërmjet konsumatorëve dhe shoqërive UK.

Kjo qasje ndërmjetësuese, ka rritur ndjeshëm angazhimin e shoqërive UK si palë pjesëmarrëse aktive në procesin e shqyrtimit të ankesave, duke nxitur zgjidhje konkrete dhe në kohë të problematikave të evidentuara.

6. Të marrë masat që faqja e ERRU-së në internet apo edhe faqet e ERRU-së në rrjetet sociale të kenë në fokus konsumatorin dhe ndërgjegjësimin e tij për rolin ndëreveprues që ka në marrëdhënie me ofruesit e shërbimit. Linku ku konsumatorët mund të paraqesin ankesë në ERRU, si dhe informacioni përkatës për të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit duhet të kenë një vend kryesor.

Në zbatim të objektivave të përcaktuara për vitin 2025 si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimin e Kuvendit të Shqipërisë për forcimin e rolit të konsumatorit në sektor, ERRU ka ndërmarrë masa konkrete për ta vendosur konsumatorin në qendër të komunikimit institucional. Krahas rubrikës së dedikuar konsumatorëve, Formulari i Ankesës është vendosur gjithashtu në një pozicion kryesor në faqen zyrtare të institucionit www.erru.al, në mënyrë që çdo konsumator të ketë mundësi të paraqesë kërkesat/ankesat e tij pa barriera procedurale dhe në kohë reale. Paralelisht, në rrjetet sociale të saj, ERRU ka zhvilluar një fushatë ndërgjegjësuere/informuese me poste të dedikuara për konsumatorët, ku përmbledhen qartë të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga Kontrata e

Shërbimeve UK. Në serinë e publikimeve “A e dini se?” trajtohen çështje konkrete si: cilësia e ujit, ndërhyrjet e paligjshme në rrjet, pezullimi i kontratës nga konsumatori, e drejta për ankesë, e drejta për dëmshpërblim e të tjera. Këto iniciativa të komunikimit të hapur dhe informimit të vazhdueshëm pasqyrojnë angazhimin e ERRU-së për të forcuar besimin e publikut si dhe për të ndërtuar një kulturë bashkëpunimi dhe përgjegjshmërie të ndërsjellë, ku konsumatori informohet, ndërgjegjësohet dhe vendoset në fokus të vëmendjes së politikave rregullatore.

7. ERRU, nga njëra anë, para vendosjes së objektivave përkatëse për Treguesit Kryesorë të Performancës për shoqëritë UK rajonale të kryejë një analizë të detajuar tekniko-ekonomike bazuar në mundësitë reale që ka çdo shoqëri UK dhe nga ana tjetër të ndjekë me rigorozitet zbatimin e këtyre objektivave të vëna dhe në rast se këto objektiva nuk arrihen të mos miratojë rritje tarifash kur këto shoqëri të aplikojnë sërish.

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit dhe në përputhje me Metodologjinë dhe procedurën për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime, ERRU e ushtron kompetencën e miratimit të tarifave mbi bazën e një analize të argumentuar tekniko-ekonomike, duke respektuar parimet themelore të politikës tarifore: mbulimi i kostove, efikasiteti, përballueshmëria dhe nxitja e performancës.

Përpara përcaktimit të objektivave për TKP-të, ERRU mbështetet në elementët që kërkohen nga metodologjia e tarifave dhe dokumentacioni shoqërues i aplikimit, duke kryer vlerësim të detajuar për secilën shoqëri UK, përfshirë:

- Bazën e kostove (O&M dhe elementë të tjerë të lejueshëm), duke shmangur transferimin në tarifë të kostove jo të arsyetuara/jo eficiente;
- Performancën aktuale dhe tendencat (p.sh. arkëtimi, humbjet, energjia, personeli/produktivitet, cilësia e shërbimit) si bazë reale për objektivat;
- Kapacitetin financiar dhe investimet, si dhe ndikimin e tyre në koston për njësi shërbimi;
- Përballueshmërinë dhe ndikimin social të rritjes së tarifës.

Kjo qasje është e lidhur drejtpërdrejt me filozofinë e metodologjisë: rritja e tarifave nuk konsiderohet “automatike”, por justifikohet vetëm kur është e mbështetur në kosto të arsyeshme dhe në përmirësime të matshme të performancës.

Në përputhje me kërkesat procedurale dhe instrumentet e raportimit, ERRU do të ndjekë zbatimin e objektivave përmes: raportimeve periodike (vjetore/periodike) sipas formatit rregullator dhe bazës së të dhënave të sektorit; verifikimit të treguesve dhe analizës krahasuese (benchmarking) ndërmjet shoqërive; evidentimit të devijimeve dhe kërkesës për plan korrigjues me masa konkrete dhe afate.

Në rast se shoqëria UK nuk realizon objektivat e vendosura, ERRU, në zbatim të metodologjisë së tarifave (parimi i efikasitetit dhe mbrojtjes së konsumatorit), aplikon qasjen rregullatore si vijon:

- nuk miraton rritje të mëtejshme tarifash në aplikimin pasues, për aq sa mosrealizimi i objektivave tregon mungesë përmirësimi/efikasiteti. Objektivat sipas përcaktimeve të metodologjisë së tarifave, vlerësohen me pikë bonus apo penalitet për përmbushjen apo mospërmbushjen e tyre, e cila influencon direkt në miratimin e nivelit të ri tarifor për shoqëritë UK. (Kujtojmë se pas rajonalizimit dhe aplikimit të metodologjisë së tarifave,

përgjatë 2026 kemi, për herë të parë, shoqëri të cilat i mbaron periudha rregullatore dhe duhet të paraqiten për riaplikim. Tabela nr. 8, në metodologjinë e tarifave “Pikët e vlerësimit të performancës” do të filloj zbatimin e saj në momentin që shoqëria vjen për herë të dytë për aplikim tarifor).

- rishikon kërkesën për tarifë duke mos pranuar kosto jo eficiente dhe duke kërkuar masa për realizim objektivash;
- mund të kërkojë prova të zbatimit të masave korrigjuese dhe të përmirësimit të treguesve përpara çdo vendimmarrjeje të re.

8. Megjithë trendin e ngadaltë pozitiv, shoqëritë rajonale UK duhet të vijojnë përmirësimin e treguesit “Uji pa të ardhura” duke kryer investime për instalimin e matësave në burim, për një përcaktim më të saktë të sasisë së ujit të prodhuar, plotësimi 100% i klientëve me matësa individuale si dhe rritjen e faturimit. Reduktimi i “Uji pa të ardhura” ndikon direkt në kohëzgjatjen e furnizimit me ujë, uljen e kostove dhe rritjen e efikasitetit për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt me ujë për konsumatorët.

Bazuar në Bilancin e Ujit 2024, ERRU ka evidentuar se, pavarësisht një trendi të lehtë pozitiv, niveli i “Ujit pa të Ardhura (UPA)” rezulton 61% dhe kërkon ende ndërhyrje të qëndrueshme. Në këtë kuadër, ERRU ka adresuar problematikat kryesore përmes rekomandimeve konkrete drejtuar çdo shoqërie UK, të fokusuara në rritjen e matjes në burim dhe konsum, përmirësimin e faturimit, evidentimin e humbjeve reale dhe administrative, si dhe zbatimin e planeve të veprimit për reduktimin e UPA-së.

Këto rekomandime janë përdorur nga ERRU si bazë për monitorimin e performancës dhe për kushtëzimin e vendimmarrjes tarifore, duke mos pranuar në tarifë, kosto që lidhen me humbje jo eficiente.

Gjithashtu, vlen të theksohet se reforma e re në sektor, e cila aktualisht është në proces studimi, ka në fokus kryesor rritjen e nivelit të matjes në burim dhe përmirësimin e menaxhimit të humbjeve, si elementë kyç për reduktimin e “Ujit pa të Ardhura”. Në këtë kuadër, roli i institucioneve të linjës, AKUK dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore, është thelbësor për sigurimin e financimeve të nevojshme, orientimin e investimeve drejt prioritetëve të matjes dhe rehabilitimit të rrjeteve, si dhe për ndjekjen e zbatimit të masave nga shoqëritë.

Një qasje e koordinuar ndër-institucionale do të mundësonte rezultate më të shpejta dhe më të qëndrueshme në uljen e UPA-së, duke mbështetur drejtpërdrejt edhe objektivat rregullatore të ERRU për një sektor financiarisht të qëndrueshëm dhe me shërbim cilësor për konsumatorët.

9. Është e domosdoshme që në Shoqëritë Rajonale UK të kryhet një auditim i detajuar mbi efikasitetin e energjisë, identifikimin e plotë të situatës aktuale të konsumit të energjisë të pajisjeve, makinerive të ndryshme, motorëve dhe linjave, duke paraqitur mundësitë e ndërhyrjeve dhe përmirësimeve të ndryshme për uljen e konsumit të energjisë duke u fokusuar në përdorimin e burimeve alternative të rinovueshme.

Në zbatim të këtij rekomandimi, vlerësimi i situatës nga ERRU është mbështetur në të dhënat e Raportit të Performancës për vitin 2024, i cili përbën aktualisht dokumentin e vetëm të certifikuar dhe në fuqi për vlerësimin e performancës së shoqërive UK.

Bazuar në analizën e performancës për vitin 2024, ERRU ka evidentuar se kostoja e energjisë elektrike mbetet një nga zërat kryesorë të kostove operative të shoqërive UK, duke ndikuar ndjeshëm në qëndrueshmërinë e tyre financiare.

Në këtë kuadër, ERRU ka adresuar këtë problematikë, përmes rekomandimeve të qarta drejtuar shoqërive UK, duke theksuar nevojën për kryerjen e analizave të detajuara të eficiencës së energjisë, identifikimin e pajisjeve dhe sistemeve me konsum të lartë, si dhe ndërmarrjen e masave për uljen e konsumit, përfshirë investimet në pajisje me eficiencë të lartë dhe përdorimin e burimeve alternative të rinovueshme.

Këto rekomandime janë integruar në procesin e analizës tekniko-ekonomike dhe merren në konsideratë nga ERRU gjatë vlerësimit të aplikimeve për tarifa, si element kyç për kontrollin e kostove dhe përmirësimin e performancës së shoqërive UK.

10. ERRU të vendosë objektiva agresivë në drejtim të rritjes së nivelit të matjes për shoqëritë që aplikojnë për nivel të ri tarifor dhe të monitorojë përmbushjen e objektivave nga shoqëritë rajonale pasi përmbushja e tyre ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit të ofruar për konsumatorët, si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë, duke ndikuar në përmirësimin e tyre.

Në kuadër të procesit të miratimit të tarifave, ERRU ka vendosur objektiva të qarta dhe progresive për rritjen e nivelit të matjes për shoqëritë UK që aplikojnë për nivel të ri tarifor, duke e konsideruar matjen si element kyç të analizës tekniko-ekonomike.

Përmbushja e këtyre objektivave monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmes raportimeve periodike dhe Bilancit të Ujit, ndërsa rezultatet e tyre merren në konsideratë në vendimmarrjen tarifore.

ERRU vlerëson se rritja e nivelit të matjes ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së shërbimit për konsumatorët dhe në performancën e treguesve të tjerë teknikë dhe financiarë të shoqërive UK.

Për të evidentuar më qartë zbatimin e këtij parimi, në të gjitha rastet e miratimit të tarifave, ERRU nuk miraton automatikisht propozimin e paraqitur nga shoqëria, por përcakton nivelin tarifor në bazë të analizës tekniko-ekonomike dhe përputhshmërisë me objektivat e performancës.

11. ERRU-ja, në kuadër të hapjes së negociatave me BE-në, të kontribuojë në përmbushje të kërkesave të *acquis communautaire* të Shqipërisë në lidhje me Direktivat Evropiane për Ujin e Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe të Llumrave të ITUN.

Dy kapitujt në të cilën ERRU mund të japë kontributin e saj, si një aktor i përfshirë në sektor, në kuadër të procesit të integritimit, janë Kapitulli 27 "Mjedisi" dhe Kapitulli 28 "Mbrotjtja e Konsumatorit".

Për sa i përket Kapitullit 27 "Mjedisi", institucionet që ndjekin drejtpërdrejt dy direktiva që lidhen me fushën e përgjegjësisë të ERRU, përkatësisht Direktiva Nr. 91/271 "Lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura urbane" dhe Direktiva Nr. 2184/2020 "Mbi cilësinë e ujit të destinuar për konsum nga njerëzit", janë në proces hartimi të akteve. Pasi këto akte të hartohen, sikurse është dakortësuar, ERRU do të jetë pjesë e tryezave të konsultimit.

Gjithashtu, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave rregullatore dhe forcimit të kuadrit institucional rregullator të sektorit, ERRU ka orientuar veprimtarinë drejt përafrimit gradual të praktikave rregullatore kombëtare me ato evropiane, përmes proceseve të licencimit, vendosjes së tarifave dhe monitorimit të performancës së shoqërive UK.

Lidhur me kapitullin 28 “Mbrotjtja e Konsumatorit”, përgjatë vitit 2025, ERRU si pjesë raportuese e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për nën kapitullin 28 “Mbrotjtja e Konsumatorit” ka kontribuar për këtë kapitull në raportimet periodike dhe në përgatitjet paraprake të Planit Kombëtar të Përafrimit me Acquis të BE-së 2026–2027 si një nga instrumentet kryesore planifikuese për masat ligjore dhe politikëbërëse që lidhen me përmbushjen e kushteve të fazës aktuale të negociatave me Bashkimin Evropian.

Sa më sipër, institucioni jonë vazhdon të jetë aktiv në Rrjetin e Rregullatorëve Evropian të Ujit (WAREG), ku ushtron rolin e anëtarit me të drejta të plota.

4.3 Niveli i zbatueshmërisë nga Ekzekutivi i Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura

Në përmbushje të mandatit të tij ligjor, ERRU, nëpërmjet raporteve që harton dhe paraqet në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave, adreson rekomandime konkrete ndaj institucioneve dhe aktorëve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve. Këto rekomandime synojnë përmirësimin e performancës teknike dhe financiare të shoqërive UK, forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.

Ky seksion paraqet një vlerësim të nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve të adresuara nga institucionet e pavarura, bazuar në analizën e të dhënave të raportuara gjatë vitit 2025, si dhe në progresin e evidentuar në treguesit kryesorë të performancës së sektorit.

Në vijim paraqiten rekomandimet kryesore dhe statusi i zbatimit të tyre.

- ***Të planifikohen investime të dedikuara dhe të alokohen fondet përkatëse nga AKUK për pajisjen e të gjithë sistemeve të FU me ujëmatës të mëdhenj në burim dhe tek konsumatorët në mënyrë që shoqëritë UK të kenë mundësinë e vlerësimit dhe reduktimit të humbjeve, evidentimit të gjendjes reale të kërkesës për ujë dhe mbrojtjen e burimeve.***

Pajisja e konsumatorëve me ujëmatës individualë, si element thelbësor për matjen e konsumit real të ujit të pijshëm dhe si një nga treguesit kryesorë të performancës së sektorit, ka vijuar të shënojë përmirësim progresiv nga viti në vit.

Gjatë vitit 2025, niveli i matjes në sektor arriti në 89.5%, duke regjistruar një rritje prej rreth 1.6 pikë përqindje krahasuar me vitin 2024.

Ky zhvillim pozitiv është reflektuar edhe në procesin e miratimit të tarifave, ku objektivat për treguesin e nivelit të matjes, të përcaktuara nga ERRU, kanë qenë ambicioze dhe të orientuara drejt përmirësimit të performancës së shoqërive UK.

Megjithatë, progresi i arritur në nivel konsumatori nuk është shoqëruar ende me investime të strukturuar dhe sistematike për instalimin e ujëmatësve në prodhim. Aktualisht mungon një planifikim i dedikuar financiar nga AKUK për këtë komponent thelbësor të menaxhimit të burimeve ujore. Në këtë kuadër, zbatimi i plotë i këtij rekomandimi mbetet prioritet për vitin në vijim, pasi ndikon drejtpërdrejt në vlerësimin real të kërkesës për ujë, përmirësimin e bilanceve të ujit dhe reduktimin e humbjeve në sistem.

- ***Të hartohen nga shoqëritë rajonale UK “Planet e Menaxhimit të Aseteve” për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e asetëve që mund të përmirësojë efikasitetin në mënyrën se si administrohen asetet si dhe uljen e kostove të mirëmbajtjes.***

Hartimi dhe zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Aseteve përbën një parakusht thelbësor për garantimin e një planifikimi të strukturuar, afatgjatë dhe efikas të investimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve. Menaxhimi i qëndrueshëm i asetëve ndikon drejtpërdrejt në optimizimin e kostove, rritjen e jetëgjatësisë së infrastrukturës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Pas zbatimit të reformës sektoriale, shoqëritë rajonale UK kanë konsoliduar kapacitete financiare dhe administrative më të qëndrueshme, si dhe burime njerëzore të specializuara, të cilat krijojnë premiset e nevojshme për implementimin efektiv të sistemeve moderne të menaxhimit të asetëve.

Në këtë kontekst dhe në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike të sektorit, vlerësohet e nevojshme që AKUK të marrë një rol më aktiv në koordinimin, nxitjen dhe mbështetjen financiare për krijimin e një sistemi të integruar të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së asetëve, të unifikuar për të gjitha shoqëritë rajonale UK.

Për rrjedhojë, zbatimi i këtij rekomandimi mbetet prioritet për vitin në vijim, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë teknike dhe financiare të sektorit.

- ***Në përgjigje të ndryshimeve të shpejta të kushteve klimatike dhe zhvillimit të teknologjisë dhe industrisë në fushën e ujit, në bashkëpunim me AKUK, të hartohen planet afatshkurtër dhe afatgjatë të investimeve në infrastrukturën aktuale të sistemeve FU dhe KUN.***

Reforma në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve po reflekton efekte të qëndrueshme dhe progresive, veçanërisht në drejtim të konsolidimit institucional të sektorit dhe rritjes së eficiencës operacionale. Procesi i rajonalizimit ka kontribuar në përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK, si dhe në forcimin e kapaciteteve të tyre menaxheriale dhe administrative.

Megjithatë, pavarësisht progresit të arritur, sektori vijon të përballet me sfida, veçanërisht në drejtim të krijimit të një baze më të qëndrueshme për planifikimin dhe financimin e investimeve të ardhshme në infrastrukturë.

Në përgjigje të ndryshimeve të kushteve klimatike dhe zhvillimeve teknologjike në fushën e ujit, në bashkëpunim me AKUK po ndërmerren masa për vlerësimin e nevojave prioritare dhe për forcimin e koordinimit në drejtim të investimeve në infrastrukturën ekzistuese të sistemeve të furnizimit me ujë (FU) dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUN). Ky proces mbështetet në analizën e gjendjes teknike të asetëve dhe në objektivat strategjike të sektorit, me synim rritjen e qëndrueshmërisë ndaj

ndryshimeve klimatike, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe përdorimin më efikas të burimeve financiare.

Në përputhje me programet kombëtare të investimeve dhe me rolin koordinues të AKUK, shoqëritë rajonale UK vijnë të identifikojnë dhe prioritarizojnë ndërhyrjet e nevojshme në infrastrukturën e sistemeve FU dhe KUN, duke synuar harmonizimin e nevojave lokale me objektivat sektoriale kombëtare dhe ndërtimin gradual të një planifikimi më të strukturuar të investimeve.

- ***Të vijojë procesi i rishikimit dhe miratimit të kuadrit të ri ligjor rregullator në sektorin e ujit sipas zhvillimeve që ka pësuar sektori dhe rregullimi sipas standardeve dhe direktivave evropiane për ujin e pijshëm dhe largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura.***

Procesi i rishikimit dhe miratimit të kuadrit të ri ligjor dhe rregullator përbën një komponent thelbësor të reformës së përgjithshme të sektorit, si në funksion të arritjes së objektivave strategjike sektoriale, ashtu edhe të përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian.

Aktualisht, sektori vijon të funksionojë mbi bazën e kuadrit ligjor ekzistues, i cili është përditësuar dhe plotësuar nëpërmjet akteve nënligjore për të adresuar nevojat emergjente të zhvillimit dhe rregullimit të tregut.

Në kuadër të reformimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, gjatë vitit 2025 qeveria qendrore propozoi një fazë të re reformuese, e cila synon riorganizimin e sistemit përmes ndarjes funksionale të procesit të prodhimit të ujit nga ai i shpërndarjes, aktualisht i realizuar nga shoqëritë UK.

Kjo reformë pritet të reflektohet në kuadrin ligjor dhe rregullator të sektorit, me synimin për të garantuar një organizim më efikas të sektorit, rritjen e transparencës dhe përputhshmëri të plotë me kuadrin rregullator evropian.

- ***Duke patur parasysh që një pjesë të mirë të kostove të justifikuara që duhet të mbulohen me tarifa e përbëjnë investimet e reja, duhet të krijohet mundësia që ERRU të përfaqësohet për të dhënë rekomandimet e saj në komisionet teknike pranë AKUK për aprovimin e projekteve të reja për investime.***

ERRU ka kontribuar në mënyrë aktive në procesin e hartimit të draft-ligjit të ri për sektorin, duke paraqitur sugjerime dhe rekomandime të detajuara në funksion të forcimit të kuadrit rregullator dhe rritjes së efektivitetit të mbikëqyrjes sektoriale.

Një ndër rekomandimet kryesore të përcjella zyrtarisht nga ERRU ka qenë përcaktimi më i qartë i rolit të rregullatorit në orientimin e politikave të investimit, si dhe në garantimin e një shpërndarjeje më të balancuar dhe të bazuar në nevoja reale të investimeve ndërmjet shoqërive UK. Ky rekomandim synon të sigurojë një lidhje më të fortë ndërmjet planifikimit të investimeve, performancës operacionale dhe qëndrueshmërisë financiare të sektorit.

Zbatimi dhe reflektimi i plotë i këtij rekomandimi në kuadrin e ri ligjor mbetet një prioritet për periudhën në vijim, në funksion të konsolidimit të rolit rregullator dhe përmirësimit të qeverisjes së sektorit.

5. OBJEKTIVAT E ERRU-SË PËR VITIN 2026

Në vijim të progresit të arritur gjatë vitit 2025 dhe në kushtet e thellimit të reformës në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, ERRU do të orientojë veprimtarinë e saj gjatë vitit 2026 drejt konsolidimit të rolit rregullator, forcimit të qëndrueshmërisë financiare dhe institucionale të sektorit, rritjes së cilësisë së shërbimit dhe mbrojtjes së konsumatorëve. Objektivat për vitin 2026 reflektojnë nevojën për përshtatje me zhvillimet sektoriale, harmonizim me standardet evropiane dhe modernizim të mëtijshëm të kapaciteteve institucionale.

- **Konsolidimi i rolit rregullator të ERRU-së** në kuadër të zhvillimeve të reformës në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, përmes përshtatjes dhe forcimit të instrumenteve rregullatore.
- **Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe metodologjik** në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë financiare dhe eficiencës së sektorit UK.
- **Thellimi i monitorimit të performancës së shoqërive UK**, me fokus në përmbushjen e objektivave të performancës, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe rritjen e transparencës.
- **Konsolidimi i sistemit të raportimit dhe analizës së të dhënave sektoriale**, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, për mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në evidencë.
- **Mbështetja e zbatimit të Planeve 5-vjeçare të Biznesit** si instrument strategjik për planifikimin afatmesëm teknik dhe financiar të shoqërive UK.
- **Kontributi aktiv në procesin e integritetit evropian**, përmes harmonizimit gradual të praktikave rregullatore me standardet e Bashkimit Evropian.
- **Forcimi i mbrojtjes së konsumatorëve dhe rritja e besueshmërisë së institucionit**, përmes transparencës, komunikimit aktiv dhe mekanizmave efektivë të trajtimit të ankesave.
- **Nxitja e eficiencës teknike dhe energjetike në sektor**, përmes zhvillimit të instrumenteve analitike dhe monitoruese.
- Mbështetja e **konsolidimit institucional** të shoqërive UK dhe **përmirësimi i menaxhimit të aseteve** në funksion të qëndrueshmërisë afatgjatë të sektorit.
- **Modernizimi i kapaciteteve institucionale të ERRU-së**, përmes rritjes së profesionalizmit të stafit dhe avancimit të proceseve të digjitalizimit.

6. REKOMANDIME TË ERRU-SË PËR SEKTORIN UK

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve të tij rregullatore dhe monitoruese, ERRU evidenton problematika strukturore dhe operacionale, zgjidhja e të cilave vlerësohet se do të kontribuonte në përmirësimin gradual të performancës teknike, financiare dhe menaxheriale të shoqërive UK, si dhe në konsolidimin e sektorit UK në tërësi.

Referuar problematikave të konstatuara, ERRU jep rekomandimet që duhet të ndiqen nga aktorët që administrojnë sektorin UK, si vijon:

- **Shoqëritë ende nuk arrijnë të mbulojnë 100% të zonës së tyre të shërbimit me shërbimet që ofrojnë, përkatësisht furnizimin me ujë (FU), kanalizimet e ujërave të ndotura (KUN) apo impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN).**

ERRU vendos objektiva për rritjen e këtij treguesi, duke e adresuar zgjidhjen përmes investimeve të parashikuara nga shoqëritë në këto drejtime, si dhe përmes nevojës për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Aseteve, me qëllim orientimin e investimeve drejt zvogëlimit të humbjeve nga rrjedhjet, eliminimit të rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet dhe sigurimit të shërbimit edhe në zonat aktualisht të pambuluara.

Rekomandim 1, për shoqëritë UK: Shoqëritë duhet të orientojnë investimet e planifikuara në afatin e afërt drejt zgjidhjes së problematikave kryesore, përkatësisht zgjerimit të zonës së shërbimit për shërbimet që ato ofrojnë dhe hartimit të një plani të mirëstrukturuar të menaxhimit të asetëve, me qëllim zëvendësimin gradual të asetëve me nivel të lartë amortizimi. Ky orientim i investimeve do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e performancës teknike dhe në reduktimin e humbjeve teknike të sistemit.

Rekomandim 2, për AKUK: Investimet që planifikohen në afate të shkurtra duhet të adresojnë, ndër të tjera si prioritare, edhe zgjerimin e zonës së shërbimit për shoqëritë që rezultojnë me nivele të ulëta mbulimi të territorit me shërbimet FU, KUN dhe ITUN, veçanërisht ato që paraqesin nivel mbulimi nën mesataren e sektorit.

- **Niveli i matjes dhe niveli i humbjeve vazhdon të jetë ende i lartë.**

ERRU vendos objektiva ambicioze për reduktimin e këtij treguesi, ndërkohë që përgjegjësia për priorizimin dhe realizimin e investimeve përkatëse i takon shoqërive rajonale UK dhe AKUK, në përputhje me rolet dhe kompetencat e tyre në zhvillimin e sektorit.

Rekomandim 3, për shoqëritë UK: Instalimi i matësve në prodhim për të gjitha burimet ujore që shërbejnë për furnizim me ujë, si dhe pajisja me matësa e të gjithë klientëve në zonën e shërbimit, me qëllim rritjen e kontrollit mbi sasinë e ujit të prodhuar dhe të faturuar, përmirësimin e saktësisë së të dhënave dhe optimizimin e bilancit të ujit.

Rekomandim 4, për shoqëritë UK: Mbajtja aktive dhe e vazhdueshme e strukturave të Task-Forcës për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit, si dhe të rasteve të abuzimit, veçanërisht nga klientët privatë (hotele, bare dhe restorante) dhe klientët familjarë në zonat rurale, me synim reduktimin e humbjeve administrative dhe rritjen e të ardhurave nga shërbimi.

Rekomandim 5, për AKUK: Pilotimi i konceptit “Smart District Metering Areas (DMA)” përmes krijimit të 3–4 zonave pilote në shoqëritë më të mëdha, duke aplikuar matje inteligjente dhe analizë në kohë reale të humbjeve, me qëllim identifikimin më të shpejtë të problematikave dhe rritjen e eficiencës në menaxhimin e rrjeteve.

- **Normat e arkëtimit, si ajo korrente ashtu edhe ajo e përgjithshme, vijojnë të mbeten në nivele jo të kënaqshme për një pjesë të shoqërive rajonale UK.**

Përmirësimi i këtij treguesi ndikon drejtpërdrejt në rritjen e të ardhurave dhe përbën një burim të brendshëm financiar për shoqëritë, duke forcuar qëndrueshmërinë e tyre ekonomike.

Rekomandim 6, për shoqëritë UK: Shoqëritë të ndërmarrin masa të strukturuar dhe të vazhdueshme për monitorimin sistematik të klientëve me detyrime të prapambetura, si dhe për njoftimin dhe kur është e nevojshme, ndërprerjen e shërbimit ndaj klientëve debitorë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, me synim përmirësimin e normave të arkëtimit dhe rritjen e disiplinës së pagesave.

- **Pjesa më e madhe e shoqërive rajonale UK (me përjashtim të dy prej tyre) nuk arrijnë ende të mbulojnë plotësisht kostot operative të mirëmbajtjes përmes të ardhurave të gjeneruara nga aktiviteti i tyre.**

ERRU, në kuadër të proceseve të miratimit të tarifave dhe monitorimit të performancës, vendos objektiva për reduktimin e kostove të pranuar, të lidhura kryesisht me eficiencën e stafit dhe konsumin e energjisë elektrike, të cilat përbëjnë ndër zërat kryesorë të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes së shoqërive.

Rekomandim 7, për shoqëritë UK: Shoqëritë të përmirësojnë menaxhimin e kostove operative me synim reduktimin gradual të tyre, përmes racionalizimit të strukturës së punësimit, duke ndikuar në uljen e kostove të personelit, si dhe përmes hartimit të një studimi mbi eficiencën e energjisë, me qëllim identifikimin e masave konkrete për minimizimin e kostove të energjisë elektrike.

- **Shoqëritë rajonale UK duhet t’i kushtojnë rëndësi të veçantë trajnimit të stafit, veçanërisht në drejtim të përpunimit dhe gjenerimit të të dhënave të sakta për Bilancin e Ujit, raportimit teknik dhe financiar në përputhje me Metodologjinë e Vendosijes së Tarifave, si dhe në funksionimin korrekt të sistemeve të kontabilitetit.**

Rekomandim 8, për shoqëritë UK: Të mirëmbajnë dhe zhvillojnë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me Metodologjinë e Vendosijes së Tarifave, me qëllim sigurimin e saktësisë, konsistencës dhe verifikueshmërisë së të dhënave të raportuara.

Rekomandim 9, për shoqëritë rajonale UK: Të pasqyrojnë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të aseteve në përputhje me kërkesat e ERRU-së, sipas ndarjes së parashikuar në modelin e aplikimit tarifyor, në mënyrë që të mundësohet verifikimi i realizimit të investimeve të planifikuara gjatë periudhës rregullatore.

Rekomandim 10, për shoqëritë rajonale UK: Të investojnë në trajnimin e vazhdueshëm të stafit, me fokus në forcimin e kapaciteteve teknike, financiare dhe menaxheriale, në funksion të zbatimit korrekt të kërkesave rregullatore dhe përmirësimin të performancës së shoqërisë.

Rekomandim 11, për AKUK: Të mbështesë dhe të koordinojë programe trajnimi për stafin e shoqërive rajonale UK, me fokus në forcimin e kapaciteteve teknike, financiare dhe menaxheriale, në funksion të zbatimit korrekt të kërkesave rregullatore dhe përmirësimit të performancës së sektorit.

- Pesë shoqëri që janë aktualisht pjesë e strukturave rajonale UK (SHRUK Dibër, Lushnjë, Sarandë, Vlorë dhe Kukës), nuk kanë ende tarifa të miratuara nga ERRU në kuadër të organizimit të ri si shoqëri rajonale. Tarifat ekzistuese të tyre janë miratuar në strukturën e mëparshme organizative dhe nuk janë rishikuar në përputhje me konfigurimin aktual rajonal. Ndërkohë SHUK Kamëz nuk ka tarifa të miratuara nga ERRU.

Rekomandim 12, për AKUK: Të ushtrojë rolin e tij drejtues dhe koordinues për të nxitur shoqëritë rajonale UK që ende nuk kanë aplikuar, të paraqesin aplikimet për miratimin e tarifave në përputhje me aktet rregullatore në fuqi, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë financiare dhe përputhshmërisë me kuadrin ligjor.

Rekomandim 13, për Bashkinë Kamëz: Në cilësinë e aksionerit kryesor, të ndërmarë hapat e nevojshëm për të nxitur shoqërinë SHA UK Kamëz që të aplikojë për miratimin e tarifave pranë ERRU-së, në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.

- Gjatë vitit 2025, KKRR miratoi Metodologjinë për hartimin e Planeve 5-vjeçare të Biznesit për shoqëritë UK, duke vendosur një kuadër të ri rregullator për planifikimin afatmesëm të aktivitetit të tyre. Në këtë kuadër:

Rekomandim 14, për shoqëritë UK: Të iniciojnë procesin e hartimit të Planeve 5-vjeçare të Biznesit në përputhje me kërkesat e metodologjisë së miratuar. Planet duhet të integrojnë planifikimin financiar, operacional dhe të investimeve, të përfshijnë projeksione të qëndrueshme të të ardhurave dhe kostove, si dhe objektiva të matshëm të performancës, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimin afatmesëm të cilësisë së shërbimit.

Rekomandim 15, për AKUK: Të nxisë dhe të mbështesë shoqëritë UK në procesin e përgatitjes së planeve, si dhe të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme progresin e hartimit dhe zbatimit të tyre, në përputhje me kërkesat e metodologjisë së miratuar.

- Duke marrë shkas nga problematikat e evidentuara gjatë kësaj periudhe për rastet e defekteve të shoqëruara me ndërprerje të zgjatura të furnizimit me ujë.

Rekomandim 16, për shoqëritë rajonale UK: Të përditësojnë planet e menaxhimit të risqeve dhe krizave dhe në rast se nuk kanë të tilla, t'i hartojnë ato, në mënyrë që të minimizojnë problematika në furnizimin me ujë të popullatës që vijnë si rezultat i dëmtimeve apo faktorëve të tjerë të jashtëm.

Rekomandim 17, për AKUK: Të nxisë shoqëritë dhe të monitorojë në vijim proceset e përditësimit të planeve të menaxhimit të risqeve dhe krizave, apo krijimin e tyre.

- **REKOMANDIME TË TJERA:**

Rekomandim 18, për shoqëritë rajonale UK: Të hartojnë dhe të zbatojnë plane afatmesme për harmonizimin gradual të tarifave brenda shoqërive rajonale, me synim reduktimin e diferencave tarifore ndërmjet njësive përbërëse, duke respektuar kufijtë rregullatorë të përballueshmërisë për konsumatorët dhe parimet e barazisë në ofrimin e shërbimit.

Rekomandim 19, për AKUK: Të materializojë dhe funksionalizojë plotësisht sistemin e informacionit sektorial, me qëllim sigurimin e të dhënave të sakta, të plota dhe të verifikueshme për vlerësimin objektiv të performancës së shoqërive rajonale UK.

Rekomandim 20, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë: Në kuadër të ecurisë së reformës në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, MIE të identifikojë dhe të përcaktojë qartë aktorët institucionalë që, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, ndërlidhen me elementët e prodhimit të ujit, me qëllim administrimin dhe menaxhimin e qartë të procesit të prodhimit të ujit për furnizimin e popullsisë.

Njëkohësisht, Ministria të sigurojë përfshirjen aktive të këtyre aktorëve në hapat që do të ndërmerren për finalizimin e reformës, duke garantuar koordinim të strukturuar dhe bashkëpunim efektiv ndërinstitutional.

Aneksi nr. 1 Licencimet

Nr.	Operatorët	Nr. Vendimi të KKRR	Data e Vendimit të KKRR	Mbarimi i afatit të licencimit	Kategoritë e shërbimit *
1	SH.R UK Fier	37 (i ndryshuar)	20.11.2023	19.11.2027	A+C
2	SH.R UK Lezhë	579	02.12.2022	01.12.2026	A+C+D
3	SH.R UK Kukës	3 (i ndryshuar)	30.01.2023	29.01.2027	A+C
4	SH.R UK Durrës	6 (i ndryshuar)	22.02.2023	21.02.2027	A+B+C+D
5	SH.R UK Gjirokastrë	7	22.02.2023	21.02.2027	A+C
6	SH.R UK Berat	11	03.03.2023	02.03.2027	A+C
7	SH.R UK Lushnjë	12 (i ndryshuar)	03.03.2023	02.03.2027	A+C
8	SH.R UK Elbasan	16	28.04.2023	27.04.2027	A+C
9	SH.R UK Sarandë	17	28.02.2023	27.04.2027	A+C
10	SH.R UK Pogradec	18	28.02.2023	27.04.2027	A+C+D
11	SH.R UK Dibër	24	23.06.2023	22.06.2027	A+C
12	SH.R UK Shkodër	56 (i ndryshuar)	27.12.2023	26.12.2027	A+C+D
13	SH.R UK Vlorë	43 (i ndryshuar)	08.11.2024	07.11.2028	A+C
14	SH.R UK Korçë	52	20.12.2024	19.12.2028	A+C+D
15	SH. A UK Tiranë	5 (i ndryshuar)	22.02.2023	21.02.2027	A+B+C
16	SH. A UK Kamëz	102	28.02.2022	27.02.2026	A+C
17	SH.A UK Vorë	54	20.12.2024	19.12.2028	A+C

* **Kategoritë e shërbimit:** *Kategoria A* Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
Kategoria B Për përpunimin e ujit për konsum publik
Kategoria C Për largimin e ujërave të ndotura
Kategoria D Për trajtimin e ujërave të ndotura

Aneksi nr. 2 Tarifat për Shërbimin e FU dhe Largimit të UN Viti 2025

Nr.	Emri i shoqërisë rajonale	Data e hyrjes në fuqi të vendimit të tarifave	Përfundim afatit të tarifës	Situata Aktuale								
				Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm			Shërbimi i largimit të ujërave të ndotur			Tarifë fikse		
				Tarifë variabël			Tarifa variabël					
				Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a												
1	Njësia Korçë	01.08.2025	31.12.2029	72/50*	140/110*	140/100*	48/20*	80/30*	80/30*	200	200	200
	Njësia Devoll			50	100	110	20	30	30	200	200	200
	Njësia Maliq			50	100	105	20	30	30	200	200	200
	Njësia Pustec			50	100	100	20	30	30	200	200	200
	Njësia Kolonjë			50	100	110	20	30	30	200	200	200
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a												
2	Njësia Pogradec	10.08.2024	31.12.2027	65/35*	120/100*	120/100*	35/25*	50/40*	50/40*	200	300	300
	Njësia Prenjas			45/35*	100/70*	100/70*	25	40	40	200	300	300
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a												
3	Njësia Durrës	15.06.2024	31.12.2026	70	140	140	50	70	70	200	300	300
	Njësia Shijak			70	140	140	50	70	70	200	300	300
	Njësia Kavajë			50	140	140	30	50	50	200	300	300
	Njësia Krujë			48	96	100	10	20	20	200	300	300
	Njësia Rrogozhinë			48	96	100	10	20	20	200	300	300
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë sh.a												
4	Njësia Lezhë	05.04.2024	31.12.2025	65	135	145	19	25	29	200	400	400
	Njësia Kurbin			45	80	120	15	25	25	100	200	200
	Njësia Rrëshen			45	100	115	15	25	25	100	200	200
	Njësia Rubik			45	70	100	15	25	25	100	200	200
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a												
5	Njësia Dibër	01.01.2010	Deri në miratimin e tarifave të reja	27	65	85						
	Njësia Bulqizë	01.10.2022	Deri në miratimin e tarifave të reja	25	75/55*	83.3	10	17	17	100	100	100
	Njësia Mat	01.01.2006	Deri në miratimin e tarifave të reja	23	60	80	2	4	6			
	Njësia Klos		Pa tarife të miratuara nga ERRU									
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a												
6	Njësia Kukës	01.10.2022	Deri në miratimin e tarifave të reja	30	80	100	10	20	30	50	100	100
	Njësia Tropojë	01.08.2019	Deri në miratimin e tarifave të reja	30/40	80	80	13	22	22	100	100	100
	Njësia Has		Pa tarife të miratuara nga ERRU									
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a												
7	Njësia Elbasan	01.08.2025	31.12.2027	50	130	130	15	30	30	200	400	400
	Njësia Librazhd			50	100	100	15	30	30	200	300	300
	Njësia Gramsh			50	100	100	15	30	30	200	300	300
	Njësia Cërrik			50	120	120	15	30	30	200	300	300
	Njësia Belsh			50	120	120	15	30	30	200	300	300
	Njësia Peqin			50	120	120	15	30	30	200	300	300
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a												
8	Njësia Fier	18.05.2024	31.12.2026	60	115	125	20	20	20	200	200	200
	Njësia Patos			70	135	135	20	20	20	200	200	200
	Njësia Mallakastër			60	115	125	20	20	20	200	200	200
	Njësia Roskovec			60	115	125	20	20	20	200	200	200
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë sh.a												
9	Njësia Gjirokastrë	01.01.2025	31.12.2027	50/30*	133/60*	138/60*	15	20	20	200	300	300
	Njësia Tepelenë			50	100	120	15	20	20	200	400	300
	Njësia Këlcyrë			50	100	100	15	20	20	200	300	300
	Njësia Përmet			50/30*	110/60*	120/60*	15	20	20	200	300	300
	Njësia Libohovë			30	70	90	15	20	20	200	300	300
	Njësia Dropull			30	60	60				200	300	300
	Njësia Memaliaj			50	100	120	15	20	20	200	400	300
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë sh.a												
10	Njësia Lushnjë	01.10.2019	Deri në miratimin e tarifave të reja	62	130/110*	140/110*	17	21	24	100	200/100*	200/100*
	Njësia Divjakë		Pa tarife të miratuara nga ERRU									
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a												
11	Njësia Berat	01.08.2025	31.12.2027	54	130	130	16	28	28	150	250	250
	Njësia Kuçovë			54	130	130	16	28	28	150	250	250
	Njësia Dimal			50	100	100	15	20	20	150	200	200
	Njësia Skrapar			50	100	110	15	20	20	150	200	200
	Njësia Poliçan			50	100	110	15	20	20	150	200	200
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a												
12	Njësia Sarandë	01.07.2021	Deri në miratimin e tarifave të reja	60	140	140	25	45	45	200	200	200
	Njësia Finiq		Pa tarife të miratuara nga ERRU									
	Njësia Konispol	01.10.2022	Deri në miratimin e tarifave të reja	50/66.7*	83.3	83.3						
	Njësia Delvinë	01.05.2019	Deri në miratimin e tarifave të reja	58	120	120	18	35	35	167	200	200
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a												
13	Njësia Shkodër	01.01.2025	31.12.2027	55	110	110	30	40	40	200	300	300
	Njësia Fushë Arrëz			40	80	80	20	20	20	200	300	300
	Njësia Pukë			40	130	140	20	20	20	200	300	300
	Njësia Vau Dejës			55	120	120	20	30	30	200	300	300
	Njësia Malësi e Madhe			55	120	120	20	30	30	200	300	300
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a												
14	Njësia Vlorë	01.02.2024	31.12.2025	60	120	120	17	28	28	200	400	400
	Njësia Selenicë	01.07.2010	Deri në miratimin e tarifave të reja	30	80	100						
	Njësia Himarë	01.12.2019	Deri në miratimin e tarifave të reja	55	100	100	30	50	50	200	200	300
Shoqëritë e pa Rajonalizuara												
15	UK Tiranë	01.01.2018	Deri në miratimin e tarifave të reja	65	140	155	11	30	35	200	200	200
16	UK Kamëz		Pa tarife të miratuara nga ERRU									
17	UK Vorë	01.02.2020	Deri në miratimin e tarifave të reja	65	140	155	15	30	35	200	200	200

Aneksi nr. 3 Performanca viti 2024

Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	2023	2024
1	Uji Pa të Ardhura (%)	64.7	61.0
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	100.5	107.6
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	72.8	83.2
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	103.5	102.6
5	Norma e Arkëtimit Korente(%)	83.9	84.6
6	Niveli i Matjes (%)	86.5	87.9
7	Efienca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	4.56	4.43
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	16.3	17.44
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	54.8	57.0
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	75.3	77.8
11	Efienca e Energjisë FU (kwh/m ³)	0.63	0.66
12	Ankesat e Klientëve (%)	4.23	4.64

Aneksi nr. 4 Bilanci i Ujit 2024

Emërtimi		Njësia	Viti 2024	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	të matur	m ³	196,355,861	64.8%
	të vlerësuar	m ³	106,460,191	35.2%
Volumi total i ujit që futet në sistem		m³	302,816,052	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur		m ³	92,193,195	30.42%
Konsum i ujit të faturuar të matur që shitet tek të tretë		m ³	8,058,425	2.66%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur		m ³	17,832,189	5.88%
Faturimi total		m³	118,083,809	38.97%
Konsumi i Ujit të pa faturuar për sistemet zjarrfikës, pastrim deposh etj.		m ³	2,778,316	
a) sistemi zjarrfikës (nëse dhurohet)		m ³	1,212,040	0.40%
b) Institucionet fetare dhe bamirësie (kisha, xhami, jetimore, azil, etj.) (nëse dhurohet)		m ³	403,655	0.13%
c) Pastrimi i depove dhe i rrugëve		m ³	1,162,621	0.38%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar		m³	2,778,316	0.92%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit		m ³	20,456,200	6.75%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës		m ³	36,976,955	12.20%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	në prodhim	m ³	5,719,256	1.89%
	konsumatorë	m ³	27,301,186	9.01%
Humbjet e dukshme (administrative)		m³	90,453,596	29.85%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit		m ³	14,086,028	4.65%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.		m ³	5,104,181	1.68%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit		m ³	4,361,666	1.44%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes		m ³	49,406,489	16.30%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës		m ³	18,441,890	6.09%
Humbjet Reale të ujit (teknike)		m³	91,400,254	30.16%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)		m³	181,853,850	60.01%
UJI PA TË ARDHURA		m³	184,632,166	61%

Aneksi nr. 5 Mbledhjet dhe Vendimet e KKRR, Viti 2025

Nr.	Data e mbledhjes	Vendime
1	06.01.2025	Vendim mbi vazhdimin e marrëdhënieve të punës për znj. J. Ballo
2	13.01.2025	Vendim për detajimin e planit të shpenzimeve operative të ERRU-së për vitin 2025
3	13.01.2025	Vendim për miratimin e planit të aktiviteteve ndërkombëtare për vitin 2025
4	11.02.2025	Vendim për miratimin e raportit vjetor të aktivitetit të ERRU-së për vitin 2024
5	06.03.2025	Vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 19 të KKRR-së datë 24.06.2024
6	06.03.2025	Vendim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës z. S. Kraja
7	19.03.2025	Vendim për shtyrje afati të miratimit të tarifave për Shoqërinë Rajonale UK Korcë
8	19.03.2025	Vendim për dhënie ndihme në rast fatkeqësie
9	19.03.2025	Vendim për derdhje në buxhet
10	17.04.2025	Vendim për shtyrje afati të miratimit të tarifave për Shoqërinë Rajonale UK Berat
11	17.04.2025	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR-së për licencimin e Shoqërisë Rajonale UK Vlorë
12	17.04.2025	Vendim për shtyrje afati të miratimit të tarifave të Shoqërisë Rajonale UK Elbasan
13	30.04.2025	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR për licencimin e shoqërisë UK Tiranë
14	30.04.2025	Vendim për shpallje vendi vakant Drejtor Drejtorie pranë Drejtorisë Tekniko-Ekonomike
15	29.05.2025	Vendim për emërimin në detyrë në pozicionin Drejtor Drejtorie znj. E. Kuçi
16	29.05.2025	Vendim për një ndryshim në KKRR për detajimin e planit të shpenzimeve operative të ERRU-së për vitin 2025
17	16.06.2025	Vendim për emërimin në detyrë z. K. Koldashi
18	01.07.2025	Vendim për miratimin e tarifave për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan
19	01.07.2025	Vendim për miratimin e tarifave për Shoqërinë Rajonale UK Korçë
20	01.07.2025	Vendim për miratimin e tarifave për shoqërinë rajonale UK Berat
21	14.07.2025	Vendim për shtyrje afati për procedurën e aplikimit për nivel të ri tarifar për shoqërinë rajonale UK Lezhë
22	14.7.2025	Vendim për shtyrje afati për procedurën e aplikimit për nivel të ri tarifar për shoqërinë rajonale UK Kukës
23	14.07.2025	Vendim për miratimin e raportit të performancës për vitin 2024
24	01.09.2025	Vendim për vijimin e marrëdhënieve të punës znj. E.Kuçi
25	01.09.2025	Vendim për dhënie ndihme në rast fatkeqësie z. E.Sula

26	11.09.2025	Vendim për vijimin e marrëdhënieve të punës znj. S. Kostare
27	11.09.2025	Vendim për vijimin e marrëdhënieve të punës z. K. Koldashi
28	11.09.2025	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR-së datë 13.01.2025
29	29.09.2025	Vendim për miratimin e planit të shpenzimeve operative të ERRU-së
30	29.09.2025	Vendim për caktimin e zëvendës kryetarit Z. G. Gjeci
31	13.10.2025	Vendim për shtyrje afati për plotësimin e dokumentacionit për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë
32	13.10.2025	Vendim për refuzimin e aplikimit për nivel të ri tarifor të shoqërisë rajonale UK Kukës
33	14.11.2025	Vendim për miratimin e planit të biznesit 5 vjeçar për shoqëritë UK
34	14.11.2025	Vendim për miratimin e bilancit të ujit për vitin 2024
35	14.11.2025	Vendim për shtesë në rregulloren e licencimit për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike dhe fizike
36	20.11.2025	Vendim për disa ndryshime në vendimin e KKRR-së nr. 6, datë 22.02.2023 për licencimin e shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Durrës
37	20.11.2025	Vendim për licencimin e Shoqërisë Rajonale UK Fier
38	27.11.2025	Vendim për shpërblimin vjetor të Sekretarit të Përgjithshëm
39	27.11.2025	Vendim për shpërblimin vjetor të Kryetarit të KKRR-së
40	11.12.2025	Vendim për refuzimin e aplikimit për nivel të ri tarifor të Shoqërisë Rajonale UK Lezhë
41	11.12.2025	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR-së nr. 7, datë 06.03.2024 për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale UK Lezhë
42	22.12.2025	Vendim për një ndryshim në vendimin nr. 37, datë 20.11.2025 për licencimin e shoqërisë rajonale UK Fier
43	22.12.2025	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR-së nr. 2, datë 13.01.2025 për detajimin e planit të shpenzimeve operative të ERRU-së
44	29.12.2025	Vendim për rishikimin e miratimit të planit të shpenzimeve operative të ERRU-së për vitin 2026
45	29.12.2025	Vendim për anulimin e vendimit të KKRR-së nr. 40, datë 11.12.2025 për refuzimin e aplikimit të shoqërisë rajonale UK Lezhë për nivel të ri tarifor
46	29.12.2025	Vendim për shfuqizimin e vendimit të komisionit nr. 41, datë 11.12.2025 për një ndryshim në vendimin e KKRR-së nr. 7, datë 06.03.2024 për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë
47	29.12.2025	Vendim për fillim procedure për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të nivelit tarifor të Shoqërisë Rajonale UK Lezhë

Aneksi nr. 6 Referencat Ligjore

- Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102);
- Ligji nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” (ligji nr. 120/2016);
- Ligji nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” (ligji nr. 111/2012);
- Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar (ligji nr. 9902);
- Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121);
- Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (Kodi i Procedurave Administrative);
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Kodi i Punës);
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (ligji nr. 10296);
- Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar (ligji nr. 9584);
- Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” (ligji nr. 8480);
- Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (ligji nr. 119/2014);
- Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar (ligji nr. 139/2015);
- VKM nr. 958, datë 6.5.2009 “Për Miratimin e Kategorive të Licencimit dhe Procedurave të Aplikimit për Licencë të Operatorëve që Ushtrjnë Veprimtarinë në Sistemet e Furnizimit me Ujë, të Largimit dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotura” (VKM nr. 958);
- VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe kanalizime në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizime sh.a.” (Kodi i Ujit);
- VKM nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63);
- VKM nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” (VKM nr. 302);
- VKM nr. 448, datë 26.7.2023, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2023–2030” (VKM nr. 448);
- VKM nr. 326, datë 29.05.2024, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut 2024–2030” (VKM nr. 326);
- Vendim i Kuvendit nr. 33/2022, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU);
- Vendimi i KKRR nr. 29, datë 08.12.2009, i ndryshuar “Për Procedurat e Dhënies dhe Rinovimit të Licencave Profesionale për Subjektet Juridike e Fizike që Ushtrjnë Veprimtari në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, (Rregullore e licencimit);

- Vendimi i KKRR nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, i ndryshuar (Metodologjia e Tarifave);
- Vendimi i KKRR nr. 420, datë, 29.09.2022 “Për licencat dhe tarifat e shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjekte me kompetenca të përbashkëta”;
- Vendim i KKRR nr. 30, datë 23.09.2024, “Për miratimin e Strategjisë Institucionale të Entit Rregullator të Ujit 2025 – 2027”;
- Vendim i KKRR nr. 35, datë 14.11.2025, “Për një shtesë në rregulloren e licencimit “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar.

